

● GREVA E URISE

► FAQE 2-3

Kaos mes grevistëve, tërhiqet mjekja, harroi se u pushua nga privati

Kush janë ata që kanë hyrë në ngujim dhe pse janë shkarkuar



KUVENDI

“Droga” kalohet nga batutat në kërcënime

Plas sherri i narkotikëve, rrëzohet “Komisioni Hetimor 2”

► FAQE 4-5



# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI IV - NR. 119 - E PREMTE - 23-05-2014

NA NDIQNI EDHE ONLINE

www.shqiptarja.com

...origjina e lajmit...

## DESHMIA EKSKLUZIVE



# MASHTRIMI

## KOMPANIA DOREZON UJE ALBPETROLI E BLEN SINAFTË

Zbulohet skandali i fundit para zgjedhjeve 2013. Heton Prokuroria. Dëmi në një muaj 133 milionë lekë

► FAQE 8-9

### Satirë politike



NGA ARBEN DUKA

### Aksioni antikombëtar i opozitës..

(Pjesa e dytë)

► Në faqen 20

bashkë me "Të mbajmë gjallë të vërtetën.."

### Koment



### Martin Schulz: “E kuqja, jeta ime”

PËtjetës së reporterëve, se cila është ngjyra e preferuar Martin Schulz i përgjigjet: “E kuqja. Unë u përkas të kuqëve. Kjo është jeta ime.” Që prej 30 vjetësh Schulz bën politikë për të kuqtë, socialdemokratët. Fillimisht ai e nisi karrierën në politikë si kryetar bashkie në qytetin e tij Würselen, për të vazhduar më tej në postin e kryetarit të grupit parlamentar të socialistëve në Parlamentin Europian, e më pas si presidenti i Parlamentit, ndërsa tani në zgjedhjet europiane është kandidati kryesor për postin e presidentit të Komisionit të BE-së. Martin Schulz do të ngjitet lart, për këtë s'ka asnjë dyshim. “Ne kemi nevojë për njerëz, që kanë guxim. Nëse më lejoni, atëherë po ju them, që këtu...

► vijon në faqen 18

### EKSPOZITA

► FAQE 19

### ZBULOHEK POEZIA E PANJOHUR E ÇAJUPIT PËR PRINC VIDIN



### REFORMA TERRITORIALE

► FAQE 6-7

### Himara kalon njësi më vete, jo zone minoritare

Kalon varianti me 39 njësi, zvogëlohet territori i Tiranës

## » MITINGU

**STRUKTURAT** e Partisë demokratike kanë nisur që një javë më parë organizimin për mbledhjen e sa më shumë militantëve



## Opozita e bashkuar përpara kryeministritë

— Aleatët e Partisë Demokratike ku përfshihen edhe partitë jo parlamentare do të jenë pjesë e tubimit të sotëm përpara kryeministritë. Kjo gjë është faktuar pas takimi të Bashës me aleatët e tij pak ditë më parë në selinë qendrore të Partisë Demokratike.



## Militantët me autobusë në Tiranë

— Anëtarët e Partisë Demokratike do të vijnë sot në Tiranë me autobusë. Ardhja e tyre në kryeqytet është përlogaritur që të bëhet një orë përpara fillimi të protestës së opozitës në mënyrë që të kenë mundësi që të organizohen për tubimin e demokratëve.

# PD-ja protestë dhe grevë 30 ditë para statusit të BE

Tubimi, Basha i heq fjalën Berishës, kopje e protestës së 20 shkurtit, ja SMS-ja e kryetarit për militantët

**ERVIN KOÇI**  
TIRANË

**N**jë muaj përpara marrjes së përgjigjes për statusin e vendit kandidat, Partia Demokratike organizon protestën përpara kryeministritë. Sipas axhendës së BE-së për çështjen e integritetit të Shqipërisë, theksohet se në datën 3 qershor, Komisioni Europian do të zbardhi progres-raportin ndërsa në datën 4 qershor në Tiranë do të zhvillojë takimi i nivelit të lartë ku Komisioneri Fyle do të vijë në Shqipëri. Krahas kësaj, në datën 23 qershor, do të jepet edhe përgjigja për statusin nga ana e Këshillit Europian, një muaj pas protestës së organizuar nga PD. Kjo pasi ditën e sotme, në 23 maj PD organizon protestën e radhës përpara kryeministritë me synimin për rrezimin e qeverisë dhe bëhet 1 muaj pasi të jepet përgjigja finale nga BE-së për çështjen e statusit.

**4 QERSHOR**  
Një ditë pas publikimit të progres-raportit, në Tiranë vjen eurokomisioneri Fyle në takimin e Nivelit të lartë

**23 QERSHOR**  
Jepet përgjigja përfundimtare për marrjen e statusit kandidat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian

kryetarit, fjalën do ta marrin edhe qytetarë të ndryshëm që do të hedhin akuzë ndaj qeverisë. Slogani më i ri i dalë nga PD-ja është "Rama shko në shtëpi. Rama mbaj përgjegjësi". Ndryshe nga protesta e datës 15 maj, këtë herë fjalën nuk do ta mbajnë deputetët e PD-së, por kjo protestë e Partisë Demokratike është një fotokopje e protestës së PD-së në datën 20 shkurt të vitit 2014. Në këtë protestë foli vetëm Basha së bashku me disa protestues dhe asnjë person tjetër nga PD-ja. Kësisoj Basha ditën e sotme do t'i mohojë të drejtën e fjalës

Salit Berishës, i cili në protestën e 20 shkurtit u pa shumë pasiv dhe shpërtheu një javë më vonë në seancën plenare të 27 shkurtit, ku për rreth 12 orë mbajti fjalime të stërgjata në Kuvend duke akuzuar mazhorancën për çdo gjë.

**BASHA SMS**

Krahas kësaj, për mbledhjen e sa më shumë protestuesve, Basha i ka nisur një SMS të gjithë militantëve të Partisë Demokratike. Burime nga selia blu bënë me dije për gazetën "Shqiptarja.com" mesazhin telefonik të dërguar nga Basha. Konkretisht në të thuhej: "I nderuar anëtar i PD, ditën e premte në orën 11, te ftoj të manifestojmë kundër narkotrafikut me sybllyje dhe implikimin qeveritar. Ne nuk pajtohemi me kartelin e drogës dhe nuk do rrimë menjëherë kur vendi dhe e ardhmja jonë janë në rrezik. Bashkoheni dhe ti me familjarët, miqtë dhe shokët e tu, me marshimin e madh popullor të protesta para kryeministritë. Kundër drogës, Pro Shqipërisë europiane. Edi Rama në shtëpi. Me respekt, Lulzim Basha"

**ORGANIZIMI**

Protesta e Partisë Demokratike do të jetë më e organizuar se sa ajo e të enjtes e javës që lamë pas. Konkretisht Basha nisi turin e takimeve që të hënën që lamë pas me synimin e vetëm për të mbledhur sa më shumë militant për në protestë. Krahas kësaj, edhe strukturat e Partisë Demokratike kanë nisur që prej dy javësh punën për të afruar sa më shumë demonstrues përpara kryeministritë. Protesta e sotme do të nis që në orën 10:00 me grumbullim në militantëve. Konkretisht autobusët nga rrethet do të nisen disa orë më parë me synimin e vetëm që në orën 10:00 të jenë në kryeqytet. Krahas kësaj, militantët e Tiranës do të mbledhen të gjithë në tri vende, tek sheshi "Skënderbej", tek selia e demokratëve dhe tek çadrat e grevistëve të urisë. Pasi grumbullimit të tyre, ata do të mbledhen të gjithë përpara kryeministritë. Në bulevard do të jetë e ndërtuar një podium nga ku do të mbajë fjalën kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Krahas



Grevistët (në rreth) biznesmeni Artan Murziri dhe SMS-ja e dërguar nga Basha për militantët

## PD 4 vite më parë: Grevat janë anti-integrim

Fjalimet e deputetëve për çadrat e PS në opozitë

**Partia e cila katër vite më parë ishte në pushtet i shikonte grevat e urisë si anti-integrim, sot çuditërisht një muaj nga vendimi i BE, del në kundërshtim me veten.**

— Partia e cila katër vite më parë ishte në pushtet i shikonte grevat e urisë si anti-integrim, sot çuditërisht një muaj nga vendimi i BE, del në kundërshtim me veten.

**MESILA DODA. KUVEND 24/05/2010**

— Të nderuar grevistë,  
— Nëse nisemi nga modeli, më duhet t'ju rikujtoj se greva nuk është mjet i përdorur nga parlamentarët e nga partitë politike serioze. Greva e urisë është arma e më të dobët, e atij që është jashtë politikës, e atij që përfaqëson një kauzë, për të cilën nuk mund të bëjë fjalë, përveçse të tërheqë vëmendjen. Greva e urisë së studentëve në vitin '91 u krye nga djem e vajza të reja, studentë, të cilët megjithëse u mbështetën fuqishëm nga PD, në asnjë rast nuk u bënë pjesë apo vegël e vendimmarrjes politike. Vendimi nuk u mor nga politika, por ishin vetë studentët që morën vendimin dhe askush prej tyre nuk bëri më pas karrierë në emër të saj. Tamam për këtë, modeli juaj ishte krejt i ndryshëm. Burra dhe gra që bartin mandate zgjedhësisht, rrezikuan jetën e tyre për një urdhër të kryetarit, në emër të pushtetit kryeministrit të munguar të Edi Ramës. Ja, pse modeli juaj është i turpshëm.

— (...) Të nderuar grevistë, themelues të lëvizjes çadriste, vlerësimi për kontributin tuaj është diçka që sot po na bie në sy të gjithëve. Asnjë nga folësit e sotëm nuk duket se është grevist dhe kjo tregon më së miri vlerësimin e kryetarit dhe të socialistëve të tjerë për hapin tuaj të pamatur, për përdorimin tuaj të shëmtuar. Një libër i shenjtë thotë: "Ka një kohë për të folur e një për të heshtur, një kohë për të luftuar e një kohë për të fituar".

**BERISHA KUVEND. 17/6/2010**

— Zoti Ruçaj, më duhet t'ju them në këtë moment se në

ambiguitetin e opozitës për vizat, për integrimin, fillimi i grevës së urisë, të ashtuquajturës grevë urie, pikërisht në momentin kur do të merrej vendimi i komisionerëve, dërgimi i letërës Presidentit të Komisionit Europian një ditë pasi u mor vendimi dhe përhëndetja e përzemërt e deklaratës së Boshninarut, tregoi një gjë: që ose ka kaos të madh në qëndrimet tuaja, ose ka një përpjekje të strukturuar për ta penguar këtë proces, të cilin, ju garantoj se në tërësi përpjekjet për të penguar një proces pa materie nuk do të mund të kenë sukses.

**ALDO BUMÇI. KUVEND 6/5/2010**

— Në fund përfaqësuesit e KE do të deklaroronin se imazhi i Shqipërisë po dëmtohet nga bojkoti dhe greva e urisë dhe më tej shtruan pyetjen se a ishte në interesin e vendit që pikërisht në momentin kur Komisioni Europian po përgatit opinionin për aplikimin e Shqipërisë si vend anëtar, PS ndërmerr grevën e urisë.

**GJOKË ULDEDAJ. KUVEND 13/5/2010**

— Pra, mjaft e shpërdoruar autoritetin e kryetarit duke diktuar dhe udhëhequr greva të tipit "Indokinë". Jeni rasti i vetëm në botë që një parti politike bën grevë urie në rrugë.

**ADRIANA GJONAJ. KUVEND 24/5/2010**

— Duke respektuar të drejtën e gjithsecilit për vetëflijim, kam gjykur se hyrja në grevë urie, sidomos e një grupi të madh ligjvënësish të PS-së, ishte e pakumtimit dhe depersonalizuere për ta.

**MAJLINDA BREGU. 24/6/2010**

— Që prej muajsh Edi Rama kërcënon me greva, protesta dhe, së fundi, edhe me bojkot të zgjedhjeve lokale... një njeri që ngrihet dhe ngriset jo me ëndërrën, por me makthin për pushtet, duhet të kuptojë të paktën tani se ai nuk ka asnjë shans që të vrasë ëndërrën shqiptare për integrim.



### Përkeqësohet njëri prej grevistëve

— Rreth orës 18:40, mësohet se shëndeti i njerit prej grevistëve, Ludovik Berishës, është përkeqësuar që në 16 orët e para të grevës dhe ai ka kërkuar ndihmë mjekësore. Ekipi mjekësor ka shkuar pranë tij. Berisha ka punuar si zjarrfikës në Berat.



### Kreu i PD Basha takim te çadra

— Rreth mesditës, kreu i PD Basha shkoi të takonte të larguarit nga puna që po zhvillojnë një grevë urie në një çadër të ngritur në krah të Kryeministrit. Ai ka hyrë në tendë ku ka qendruar pak minuta. Me të dalë, ai s'ka bërë asnjë prononcim për mediat.



### Bregu dhe Vokshi vizitë te protesta

— E pranishme në grevën e urisë, deputetja e PD Majlinda Bregu ka bërë me dije se kjo iniciativë e të larguarve nga puna s'është kauzë politike. Ndërsa Albana Vokshi e cilësoi këtë akt si një kauzë të madhe, me të cilën duhet të solidarizohen gjithë qytetarët.



### SHTOHEN TENDAT

## Berisha rrit numrin e çadrave, kërkon grevistë të tjerë

— Dy tendave të ndërtuara mbrëmjen e së mërkurës iu shtuan edhe dy të tjera, ndërsa iu bashkuan grevës edhe katër vetë, të cilët kanë bërë që në çadrën e dytë të ngritur pranë kryeministrit të jenë të vendosur 14 grevistë. Ndërsa pas mesdite janë ngritur pranë grevistëve dhe dy çadra të tjera për zhvillimin e grevës, edhe pse numri i personave në grevë mbetet i njëjtë. Vendorsja e çadrave të tjera duket se do të përfshijë në grevë më shumë persona.



Sipas koordinatorës së grevës së urisë së të larguarve nga administrata në çadrat e grevistëve do të bashkohen edhe persona të tjerë. Ndaj kjo është arsyeja pse janë shtuar çadrat e vendosura pranë kryeministrit. "Do të mirëpritën të tjerë njerëz që do t'i bashkohen grevës. Janë të shumtë ata që kanë kërkuar t'i bashkohen grevës. Urojmë që kërkesat tona të mund të degjohen dhe të ndryshojë situata. T'i japim fund kësaj situatë që krijohet me administratën sa herë ndryshohet qeveria", tha koordinatorja e grevës së të larguarve nga administrata. Grevistët, 4 gra e 6 burra kaluan natën në dy çadrat e instaluar në krahun e djathtë të Kryeministrit, ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka siguruar anën mjekësore të grevës duke vendosur një autoambulancë dhe një staf mjekësor pranë grevistëve. Pranë tyre janë instaluar edhe dy banja portative.

### Përplasja



TIRANE

**G**reva e urisë duket se ka marrë ngjyrën e një kaosi të vërtetë. Gjatë natës grevistja Mimoza Boçari është larguar prej tendave, pasi shkarkimi i saj nuk ka qenë prej institucioneve shtetërore por prej një biznesi privat ku punonte si mjekë. Por në ngujimin e të papunëve janë vendosur dhe dy biznesmenë.

Dita e dytë e grevës së urisë së përfaqësuesve të shoqatës së të larguarve nga puna në administratën publike, që kërkojnë kthimin e tyre të menjëherëshëm në vendet e punës, i ka pasur të gjitha brenda. Ka pasur politizimin e fortë dhe vizitat e deputetëve dhe kreut të PD. Në mbrëmje shëndeti i njerit prej grevistëve, Ludovik Berishës, është përkeqësuar dhe ai ka kërkuar ndihmë mjekësore. Ekipi mjekësor ka shkuar pranë tij. Ndërsa në orët e para të mëngjesit kësaj greve i janë bashkuar edhe 4 të larguar nga puna, por jo pjesë e kryesisë së Shoqatës. 14 pjesëtarëve në grevën e urisë organizuar nga shoqata e të larguarve nga puna nuk i mungojnë dhe dy biznesmenë.



Edmond Idrizi

### Grevistja

Mimoza Boçari pjesëmarrëse në dy greva të tjera. Ajo iu bashkua në 2010 grevës së urisë së PS. Gjithashtu ishte pjesë e protestës së 21 Janarit, proteston për moskthimin e pronave.

### Bindjet

"Ne është ofruar mbështetja e PD, ne kemi bindje të djathta, por kjo nuk do të thotë se ne duhet të largohemi nga puna. Tek kjo parti e gjejmë bindjen", deklaroi Qafzezi.

Ai është Edmond Idrizi, i cili ka qenë kryeinspektor në drejtorinë e Burgjeve, dhe është shkarkuar për shkak të thyerjes së etikës në punë, por sipas kësaj drejtorie ai s'ka bërë asnjë ankim në gjykatë për largimin nga puna. Siç rezultoi nga të dhënat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Idrizi prej vitit 2003 ushtron aktivitetin privat

# Dy biznesmenë në grevë, tërhiqet mjekja, harroi se e hoqën nga privati

## Kaos te çadrat. Kush janë ata që kanë hyrë në ngujim dhe kërkesat e tyre për qeverinë e Edi Ramës

### EMRAT DHE PUNA E 14 GREVISTËVE TË PARË

- **Petrit Fejzullai**, 50 vjeç, ka punuar në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore në Drejtorinë Rajonale të Tiranës.
- **Gladiola Bardhosi**, 30 vjeçe, ka punuar si punonjëse sociale me Zyrën e Shërbimit të Punësimit.
- **Nertila Qafzezi**, 28 vjeçe, ka punuar specialiste e Zyrës së Punësimit prej katër vitesh.
- **Vera Picaku**, 40 vjeçe, ka punuar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.
- **Artan Murrizi**, 45 vjeç, ka punuar inspektor në Drejtorinë e Inspeksionit në Ministrinë e Drejtësisë.
- **Olgerta Shkurti**, 35 vjeç, ka punuar në Drejtorinë Rajonale të Punësimit në Tiranë.
- **Agron Dervishi**, ka punuar inspektor në Sigurimet Shoqërore në Gjirokastrë.
- **Prengë Uka**, ka punuar punëtor gjelbërimi në ndërmarrjen numër 2 të trajtimit të studentëve në Qyteti Studenti.
- **Astrit Likaj** ka punuar në sektorin e financës në Zyrën e Punësimit në Tiranë prej 5 vitesh.
- **Ludovik Berisha**, inspektor i zjarrfikës në Berat.
- **Sokol Ukperaj**, ish-ekonomist te Sigurimet Shoqërore.
- **Edmond Idrizi**, ish-kryeinspektor te Drejtoria e Burgjeve.
- **Mehmet Cemurati**, ish-gardist.
- **Mimoza Boçari**, mjekë

si person fizik në tregtim të artikujve ushqimorë, tregtim automjete e makinerish të ndryshme. Ndërkohë që pjesa tjetër ka shërbyer nëpër zyrat e punësimit apo dhe te sigurimet shoqërore, autoriteti i ushqimit dhe vetëm një ish-

gardist është në këtë listë, të gjithë të larguar nga puna për thyerje disipline apo mungesë etike në punë. Grevistët nuk kanë pranuar që në çadër të hyjnë përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, duke thënë se ai është kujtuar shumë vonë.

## » KUVENDI

## Edi Rama: Jeni me Dashon apo me policin, koha do flas

Plas sherri i narkotikëve, rrëzohet "Komisioni Hetimor 2"

ERVIN KOÇI  
TIRANE

Plasën dje akuzat ndërmjet mazhorancës dhe opozitës për trafikun e drogës. Në një seancë maratonë prej 12 orësh, opozita dhe mazhoranca u përfshinë në akuzat të forta për trafikun e drogës. Por, situata u nxeh edhe më shumë në orët e mbremjes. Me ri-ardhjen e kryeministrit Rama në sallë plasi edhe debati ndërmjet PD-së dhe qeverisë. Ish-kryeministri Sali Berisha ishte iniciatori i konfliktit më të fortë duke theksuar se: "Kur u them avionë, më flasin për mushkonja. Avionët e kanë kanabisin - rimorkio, sepse ata lëvizin për kokainë e heroinë. Pse kjo situatë e tmerrshme? Ka disa arsye, nuk është rastësi. Qytetarë më falni, por unë do them të vërtetën, sado të më kushtojë. Shkaku kryesor është tek kanaçja e qelbësirave, kur media e opozitës lëshuan moton: Qelbësira bashkohuni të përmbysim Sali Berishën, që donte të thoshte horra e falsifikatorë, bashkohuni të përmbysim Sali Berishën! Dhe kur erdhi 23 qershori, ata kërkuan haraçin!". Por pas tij erdhi edhe reagimi i kryeministrit të vendit Edi Rama. Në fjalën e tij ai theksoi se Partia Demokratike duhet të distancohet nga këto akuzë duke shtuar "Jeni kundër drogës apo me Dashon", duke ironizuar kreun e komunës Lazarat. "Ju thonë të ndaloni qeverinë, të ndaloni kapjen e drogës apo të trafikantëve.



Taulant Balla

Ju këni kapur 14 ton kurse në këtë periudhë janë kapur afër 29. Ndaheni mendjen: jeni me kultivuesit apo kundër drogës? Jeni me Dashon apo me policinë? Koha do të tregojë shumë gjëra. Edhe për punën tonë. Jeni në një gjendje shumë të rëndë, dhe nuk e di si do të shpëtoni. Ne ju duam këtu, sa më pranë vendit si opozitë", tha kryeministri Rama.

Deputeti socialiste Taulant Balla hodhi edhe akuzat më të forta ndaj Partisë Demokratike. Në fjalimin e tij pas largimit të Sali Berishës nga salla e Kuvendit akuzoi opozitën se kërkoi që të bëjnë sa më shumë zhurmë në mënyrë që të tërheqin vëmendjen nga statusi dhe nga hetimi i dosjeve penale. Duke iu referuar një mbledhje grupi të PD-së, Balla theksoi se Berisha ka

dhënë direktivat që deputetët të bëjnë gjithçka në mënyrë që të mos merret statusi dhe hetimi i dosjeve. "Të nderuar protestues nesër këni mundësi për të njohur Dash Lazon. Të gjithë këni mundësinë e artë për të njohur Dashon. Të merrni farën e mirë të Lazaratit, pasi e mbanë me vete. Këta bëjnë të gjithë këtë zhurmë pasi Berisha në mbledhjen e grupit i ka thënë deputetëve:

"Dëgjo se Rama-Meta po e marrin statusin, nuk i kapim dot më kurrë. Duhet të bëjmë çmos që statusi të mos merret. Po hetohen shumë dosje, edhe ILDKP po heton dosje pasurish, duhet zhurmë e madhe që të tremben dhe të mos të hetojnë. Bujar nuk ka ç'na bën më, janë 300 dosje nuk mbyllen dot të gjitha prandaj duhet zhurmë", pasi janë 300 dosje dhe në

disa prej tyre po hetohen në thellësi dhe rrenjëti i kanë tek Saliu", theksoi deputeti socialist Taulant Balla. Por pas përfundimit të fjalës së Ballës, erdhi menjëherë reagimi i deputetit Flamur Noka i cili bënte edhe rolin e Berishës në Kuvend pasi ish-kryetari i tij u largua nga salla. Në reagimin e tij Noka nuk e përgënjeshtrroi deklaratën e Ballës për trafikun e drogës.

që është bërë më mbledhjen e grupit të PD-së por nisi valën e akuzave ndaj Ballës si kundër reagim. Në fund të seancës, mazhoranca rrëzoi me votat e saj kërkesën e Partisë Demokratike për ngritjen e Komisionit Hetimor për trafikun e lëndëve narkotike. Partia Demokratike ndryshe nga herët e tjera, qëndroi deri në fund të seancës duke marrë pjesë në votim.

**AKUZA** e Ballës theksonte se Berisha po i trembet marrjes së statusit si edhe hetimit të dosjeve dhe për këtë duhet bërë sa më shumë zhurmë

## Debatet

## "Droga" kalohet nga batuta në kërcënim

— **KODHELI:** Duhet të tregoni pse të heshtni, pse të mos vendosim Shqipërinë nën sistemin ajror të NATO-s. Pse radarët e vëzhgimit të hapësirës ajrore detare pse ishin fikur? Këta ishin radarët e monitorimit të OTRANTOS.  
— **MEDIU:** Paletjetër që duhet protestuar kundër kësaj qeverie. Duhet të çohemi me zërin më të fuqishëm si politikan edhe qytetarë kundër qeverisë.  
— **RISTANI:** Një dëshmitar ka thënë se e ka parë Edi Ramën me hundë të mbushur me kokainë në zyrë të shtetit një fakt ky që dëshmon se ka lidhje me trafikun e drogës.  
— **BERISHA:** A e morët vesh se kush u kap me targa trafikantësh. A e dini se kush është sekretar i përgjithshëm në kryeministri? Është avokati i të gjithë klaneve kriminale.

— **DULE:** edhe një minutë zoti Berisha  
— **BERISHA:** Dakord dakord, po këtu s'është qeveria do të flas unë.  
— **BALLA:** Bëj burrërinë një herë të vetme, qëndron në sallë se ke hedhur aq balltë e pisllek sot sa të mbledhës të gjithë përrenjtë e Serbisë që bënë përmblyet nuk i balancon dot. Bëhu burrë një herë se je 70 vjeç dhe qelbësirat i more me vete.

— **NOKA:** Sot gjithë ditën u fshihen si struci  
— **RAMA:** Këtë që po bëni që nga dita e parë në opozitë është se je tapë. Tapë se nuk ju ka dalë ende pika e pushtet, por edhe tapë se jeni tapë topi. Jeni pakicë aq shumë e lastuar nga fati në 8 vitet e fundit... Jeni aq tapë sa ju duket sikur jeni vendosur në krye të një lëvizje

shpëtimtare. Dili vetë përditë. Kur vjen e enja dili këtu gjithë ditën që shqiptarët ta kuptojnë se kush jeni ju.

— **RAMA:** Nuk bën vaki the kur...mos e ço tek unë se do të dali keq pastaj. Më dëgjo mua se për analogji do të dali keq kur të dali  
— **NOKA:** Nuk ja vlen që të merrem gjatë me replikën. Zoti drejtues e seancës merret vetëm me shkopin tim, i thoni se nuk i shkon që të rrijë gjithë kohës me shkopin tim në gojë.

— **BRACE:** Droga u kap në Ekuador. A e dini se ku i bie Ekuadori? U ngrit një injorante këtu dhe tha ja ku të kapën 89 kilogram kokainë. Kjo është e vërteta pasi të lutem shumë kthejeni këtë seancë në ligjshëri  
— **STRAZIMIRI:** Çmimin e parë këtu e merr mis kokaina. Erdhi duke u përdredhur, tha: "Peace in the World" dhe iku duke u përdredhur.



Mimi Kodheli



## HAPËSIRA AJRORE

## Ministrja Kodheli: Berisha për 2 vjet nuk e futi në NATO

— Ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli theksoi dje se Partia Demokratike për 2 vjet nuk ka pranuar që hapësira ajrore shqiptare të futet në sistemin e NATO-s. Në fjalën e saj në Kuvend theksoi se në një korrespondencë ndërmjet NATO-s dhe ish-atasheut shqiptar në Bruksel, Kristaq Gerveni ku tregohet mohimi i palës shqiptare për futjen në këtë sistem. "Është një sistem i integruar ajror i NATO-s që

Shqipëria të bëhet pjesë e këtij sistemi. Që nga shtatori i 2011 ka një korrespondencë shqetësuese midis përfaqësuesit tonë në Bruksel dhe qeverisë shqiptare. Këtu është një pjesë e korrespondencës, ndërkohë që qeveria juaj nuk e shihet të qartë që të jepet përgjigje. Çështje prioritetesh. Duhet të tregoni pse të heshtni, pse të mos vendosim Shqipërinë nën sistemin ajror të NATO-s", theksoi Kodheli.

## MONITORIMI I DETIT

## "Nuk i vutë në punë radarët për monitorimin e Otrantos"

— Riaktivizimi i sistemit të radarëve në muajin janar të këtij viti është cilësuar nga ana e ministres Kodheli si një arritje pasi tani më kontrollohet hapësira detare. "Tashmë jam e bindur se gjithçka po e bëni me keqdashje. Do të doja vetëm një shpjegim minimal pse nuk i këni vënë në punë radarët që monitorimin kanalin e Otrantos? Pse dy vjetësh ata nuk punonin dhe u vunë

në funksionim vetëm në janar. Ju këni bërë shumë shkelje në vite, duke i çuar FA në limitet dhe emëronit, admiralë që vinin grada gabim apo kolonël që vidhnin, male të tëra faturash të paguarash, më shumë se 16 milionë euro dhe aty nuk ka asnjë faturë që të ketë të bëjë me FA-të? E theksoj se FA-të kanë zero të bëjnë me trafikun e drogës", theksoi Kodheli.



Sali Berisha duke u drejtuar me dorë Edi Ramës dhe në Kuvend

## Dekreti

Nishani ktheu ligjin për ILDKP duke argumentuar se i janë shkelur kompetencat, por mazhoranca e rivotoj ligjin duke e fuqizuar sërish

ERVIN KOÇI  
TIRANË

**M**azhoranca rrëzoi dje dekretin e Nishanit për kthimin e ligjit për ILDKP-në. Në seancën e djeshme plenare, deputetët e opozitës akuzuan mazhorancën se po kërkon të kap institucionet e pavarura, duke ribërë të njëjtin debat të tri javëve më parë në Kuvend. Por kthimi i ligjit nga ana e Nishanit nëpërmjet një dekreti, solli edhe ironinë e socialistëve përsa i përket veprimit të kryeministrit. "Presidenti do të mbahet mend si personi që ka qarë më shumë. Shpresoj që arsyetimi që ka bërë në kthimin e ligji mosta ta ketë shkruar këshilltari që e ka banim në Gjykatën Kushtetuese. Unë e kuptoj qëndrimin tuaj për shkak të dosjeve që kemi përgatitur. Kreu i ILDKP ka mandat 5 vjeçar. Kështu në vitin 2019 atij i ka mbaruar mandati. Zgjedhjet e ardhshme janë në 2017, a do ti fitoni ju këto zgjedhje? Ju në subkoshiençën tuja e dini që do ti humbisni prandaj bëni liftë", - theksoi deputeti socialist Armando Subashi.

Pas fjalës së tij erdhi edhe reagimi i demokratëve. Nëpërmjet deputetit Gent Strazimiri, PD theksoi se mazhoranca po kërkon që të kap institucionet e pavarura, por duke hedhur doza të forta ironie për Subashin. "Në vend të Kushtetutës flet Armando dhe thotë broçkulla. Sikur kushtetuta në vitin 1998 kishte një shkop magjik dhe e dinte që në vitin 2004 do të krijohet një institucion", - tha Strazimiri.

## TOPALLI-HYSI

Çështja e ILDKP-së u nxehe edhe më shumë në momentin ku fjalën e mori deputetja e PD-së Jozefina Topalli. Me një ton ironik ndaj qeverisë, ajo theksoi se sa herë bëhet fjalë për kontrollin e parave, kabineti qeveritar largohet ngas salla e Kuvendit. "Është e çuditshme se sa herë flasim për para kjo sallë është bosh. Sot kjo mazhorancë ka parat dhe ka pushtet. Kur merr gjithë këtë pushtet kalon në overdozë dhe pëson një morfozë. Është paraja që ju vjen nga droga që ju pasuron kaq shumë", - theksoi Topalli. Pas fjalës së ish-kryeparlamentares, deputetja Vasili

## Hysi

Deputetja socialiste Vasili Hysi i kërkoi dje mazhorancës që të miratojnë një draft ku të gjithë deputetët dhe ministrat të bëjnë menjëherë deklarinimin e pasurisë



# Rrëzohet dekreti i presidentit për kthimin e ILDKP

Subashi: Nishani do mbahet mend si qaraman. Topalli: Sa herë flitet për para, qeveria zhduket nga Kuvendi

## Kushtetuta

Në debatin për ILDKP, PD theksoi se po shkelte Kushtetuta ndërsa PS e cilësoi si mashtrim, por propozoi që të bëhen ndryshime kushtetuese për këtë çështje



## Mandati i Endira Bushatit

# Mazhoranca miraton vakancën e kreut të AMA-s

— Kuvendi miratoi dje me votat e mazhorancës memon që përcakton vakancën e kryetares së Autoritetit të Medias Audiovizuale. Në debatin për këtë pikë të rendit të ditës, deputetët e opozitës theksuan se kjo është një tentativë për të kapur institucionet e pavarura. Në emër të PS-së, deputeti Alfred Peza sqaroi edhe çështjen e mandatit të Endria Bushatit. "Mandati si anëtar e Endria Bushatit ka përfunduar më 24 shtator 2012, si kryetare ka marrë një mandat më korrik 2011. Bushati duhet

të ishte rizgjedhur si anëtar e AMA-s gjë që nuk është bërë. Nuk mund të jesh kryetar i AMA-s pa qenë anëtar i saj. Ka një vendim gjykatë që na tregon se nuk mund të jesh kryetar i AMA-s, edhe ligji thotë se nuk mund të zgjidhesh kryetar i AMA-s pa qenë anëtar." -tha Peza. Por kjo gjë do ta çoi PD drejt kushtetuese pasi në një intervistë të dhënë për gazetën "Shqiptarja.com" pak ditë më parë, deputeti Lucjano Boçi ka theksuar se Kushtetuesja është rrugëgjidha e këtij problemi.



Alfred Peza

Hysi i bëri një propozim demokratëve. Në fjalën e saj ajo kërkoi që të gjithë deputetët e Kuvendit së bashku me kabinetin qeveritar të miratojnë një ligj që të bëjnë

në mënyrë të menjëhershme deklarinimin e pasurisë së tyre. "Ejani të miratojmë një ligj që të deklarojmë të gjithë pasurit tona. Zonja Topalli ejani dhe ta bëjmë ligjin që të mos ble-

jmë pasgjë me para cash por vetëm me llogari bankare", - thekoi Hysi, por Topalli nuk e pranoi këtë gjë duke shtuar se e kanë bërë deklarinimin e pasurisë.

FOTOLAJMI



## ISH-I PERNDJEKURI TAKON RAMEN: I KERKON PUNE NE SHJET

Teksa është shkëputur nga seanca parlamentare për pak momente, kryeministri Edi Rama ka takuar jashtë godinës së Kuvendit, qytetarë të thjeshtë të cilët i kanë përcjellë kërkesat e tyre. Kujtim Kaziu, ish- i përndjekuri i cili pak kohë më parë tentoi të vetëdijëj ndërsa fliste për mediat në lidhje me dëmshtëpërbllimin, takoi kryeministrin dhe i rrëfeu atij problemet ku i kërkoi punë shteti me jomë pak se 15 mijë lekë në muaj

## SHPLLJE E ANKANDIT TË PARË NGA PËRMBARUESI GJYQËSOR HELIDON XHINDI

Përshkrimi i pasurisë:

- Objekti: "Apartament", pasuria me Nr. 192/41+1-10, me sip. totale prej 94.5 m<sup>2</sup>, Zonën Kadastrale Nr. 2460, regjistruar në Z. V. R. P. P. Tiranë. E regjistruar në emër të Shoqërisë "Busa" shpk.

Çmimi fillestar: 5.392.000 Leke (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë) Lekë.  
Data e shpalljes: 13.05.2014  
Data e zhvillimit: 27.05.2014 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambjentet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Helidon XHINDI të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8, Kati 1, Tiranë.

# » BASHKITE

**PA AUTONOMI**  
Deputetët kanë kërkuar shmangien e përcaktimeve etnike, i përket së shkuarës

# Himara kalon njësi më vete, jo zonë minoritare

Bashkohet me Vranishtin, Kurveleshin e Lukovën. Respektohet historia, shmangen ekstremistët



Reforma Territoriale

**BRAHIM SHIMA**  
TIRANE

**K**rimi i një Himare si zonë me shumicë etnike minoritare greke ka sjellë ndryshimin e variantit të kalimit me 39 bashki të Shqipërisë. Deputeti i PS Armando Subashi ka propozuar, shmangien nga koncepti i minoritetit dhe shtimin e një zone të veçantë për Himarën, duke vënë theksin në aspektin historik të saj dhe jo në atë të përkatësisë etnike. Variant që ka gjetur mbështetjen dhe të deputetëve të tjerë si të PS dhe LSI. Vetë ministri Çuçi është shprehur se nuk ka asnjë rrezik nga krijimi i një zone me etni të pastër, duke qenë se aktualisht janë tetë komuna të tilla. Ndërsa ka pranuar se në propozimin e qeverisë, mbi Himarën nuk është përdorur koncepti territorial, por ai etnik.

### PROPOZIMI

Himara do të mbetet zonë më vete territoriale, por në administrimin e saj do të jenë dhe Vranishti, Kurveleshi dhe Lukova. Në këtë mënyrë është kërkuar që të respektohet si historia e zonës, duke iu referuar qëndrimit gjatë periudhës osmane, ashtu dhe lidhjes territoriale. Gjithsesi në formën e paraqitur deputetët kanë kërkuar dhe eliminimin e një përplasjeje mes mendimeve ekstremiste greke dhe stabilitetit të zonës. Për këtë në komision u janë referuar qëndrimeve të "Agimit të Artë", por dhe politikanëve të ndryshëm të cilët për gjatë viteve kanë shprehur idenë

### BRAHO

Kreu i "Agimit të Artë" qen bir Qeni



— Thirrjet e "Agimit të Artë" në Greqi, për sa i përket marrëdhënieve me Shqipërinë kanë sjellë dhe shpërthimin e deputetit të LSI, Spartak Braho. "Si ai tullaci kokëmadh që është qen e bir qeni dhe flet për Vorioepirin", tha Braho në Komision. Ndërsa shton se dhe në Greqi ka zona me komunitet çam, por se deri më tani në një ndarje territoriale nuk është vendosur si zonë minoriteti. "Ka pas çamë në Greqi dhe ka zona me çamë. Por a ka një ndarje në Greqi me zonat që i përkasin këtij komuniteti? S'e besoj", tha Braho. Ndërkohë, Bashkim Fino i tërhoqi vërejtje deputetit të LSI se po realizohet ndarja territoriale në Shqipëri jo në Greqi.



### Bashkëekzistenca

Frika për krijimin e një kërkesë për autonomi nuk qëndrojnë pasi prej shumë vitesh

dhe të një autonomie për zonën e Himarës. Sidomos kjo dhe pas zhvillimeve mes Ukrainës dhe Rusisë. Gjë që do të shkaktonte dhe një tensionim artificial. Por, duket se edhe në rast se do të arrihet konsensusi për ndryshimin e mandateve në parlament, sipas kësaj ndarje territoriale, sërisht votat e minoritetit grek, por dhe popullsisë shqiptare do të shkonin drejt një balance. Ndërsa shmangen dhe ideja e një kërkesë për autonomi apo tenseioneve artificiale. Propozimi për krijimin e një

### KOMISIONI

Ftesë PDIU të balancojë Dulen



— Çështja e çamëve, si dhe përplasjet mbi ndarjen e zonave, sipas përkatësisë minoritare kanë sjellë dhe ftesën e rradhës për deputetët e PDIU në parlament. Duke u shprehur se asgjë nuk e ndalon zotin Dule që të kërkojë një referendum në Himarë, nëse realizohet qëndrimi i saj sipas përkatësisë etnike, Spartak Braho kërkoi që të bëhen pjesë e debatit dhe deputetët e PDIU për të dhënë një argument dhe më të qartë apo një zgjidhje dhe më konkrete. Por, duket se ftesat e mazhorancës drejt opozitës në lidhje me reformën territoriale do të mbesin vetëm në konsultimet jo zyrtare, si dhe me përballjen në votimin përfundimtar.



## Lumë sharjesh dhe fyerjesh për Berishën

Thirrja e ish-kryeministrit Berisha për qëndresë qytetare me anë të grevës së urisë të zhvilluar nga të pushuarit nga administrata publike, është kthyer në bumerang për PD-në. Në qindra komente të lëna në faqen e Berishës në Facebook lëshohen kritika nga më të ndryshme për të. Mesazhet e postuara në faqen e Berishës:



- **El So Ni:** Se ti nuk ja cove policine te denuarve politik, ja more shpirtin deri sa i detyrove te digjeshin me benzine, shan i dhjjeri te permjjerin.
- **Kristina Ikonomou:** Po akoma kerkon te jesh ne pushtet o salli...kaq vite nuk u ngope me lek... apo do e mar luzluzi tani...ik re lere rehat qeverine qe zgjodhi populli shiptar te regulloj ato qe le ti....
- **Florian Gjoni:** Po ti i dogje ne mes te tiranes more salli, i vrave kater te tjerë po prap ne mes te tiranes more salli, 21 te tjerë i vrave ne gerdec more salli. Ftoje prap kryetarin e komunes lazarat ne proteste se i kan kapur shume kto 9 muaj.
- **Desi Bixhaku:** Ti janukovic cfar bere per ata qe Benin greva kur lshë ti ne pushtet dhe ke goje dhe flet ti qe vetem keq i ke bere atij vendi.
- **Arjet Xhoi:** o salli po rri ma tamarrsha npun tande se boll na e ke pru shpirtin seriozisht rri atij npun tande gzoj ata lek
- **Arben Xhoi:** berisha po ben te pamundurën per mosmarrjen e statusit. ata plehrat qe kane hyre ne greve, ne 2005 zune vendet e te larguarve nga

- qeveria e berishes. lerini te ngordhin aty si qente.
- **Estetik Gesa:** o salli berisha je bere kloun /leri o njerzit rehat se po kan 1000 mij hallr qr nga jugu ne veri.
- **Ilir Vreto:** Po te futet dhe vete ne greve Saliu se dhe ate e kan heq nga puna si Kryeminister..
- **Sofia Prifti:** MILOSHJEVICI shiptar theret baronet e droges dhe kriminelet ne proteste. TURPE.Ku i katandis emjera PD.Ne thes te hashisht.
- **Sofia Prifti:** Te dashur miq ne protesten e PD marin pjese dhe lazaratasi se suvене mire te mbjedhate e hashashit.
- **Enrien Nebiu:** Shih kush flet. Ti i le deri sa i vune flaken vetes mbasi u talle me ish te permdjekurit per 20 vite rresh. Kur ke goje dhe ti te flassh e kur ka budallenj qe akoma te degjojne e besojne hallall te qofte ty e kokra e legenit
- **Gerd Pasmaçiu:** ik o idjot se le nam! Po kot nuk thone, pleqnia si femijeria. Edhe perrallat me gogola te duken te verteta.



## Territori

TIRANE

Dy muaj kohë do të kenë krerët e komunave dhe të bashkive për të dhënë përgjigje mbi variantin e ndryshimit të ndarjes territoriale. Komisioni miratoi dje, pa prezencën e opozitës variantin paraprak të ndryshimit të bashkive dhe të qarqeve në vend. Pas marrjes së përgjigjeve zyrtare, vërejtjeve apo dhe propozimeve për të ndryshuar kufij apo zona të ndryshme, komisioni për reformën territoriale do të rimblidhet për të dhënë një draft përfundimtar i cili do

të kalojë më pas për votim në kuvend. Kreu i komisionit Bashkim Fino dha si afat datën 22 korrik kur do të ridiskutohet projektligji si dhe për të vendosur ndryshimet e fundit. Mazhoranca e re duket se ka vendosur miratimin e projektit para mbylljes së sesionit parlamentar ku data 31 korrik mbetet si afati i fundit. Përfaqësuesit e PS kanë theksuar se do të kërkojnë dhe mbështetjen e



opozitës, por se tashmë i kanë dhe 84 votat e duhura për të realizuar ndryshimin e ligjit për ndarjen administrative, vota të cilat socialistët i kanë të siguruar. Për të shmangur një rrezikim të ndarjes territoriale mazhoranca ka vendosur të mos prek pikat ku çenohet kushtetuta, duke u kufizuar vetëm në ndarjen e bashkive dhe komunave. Për këtë proces Fino tha se në këtë reformë Shqipëria plotëson një tjetër

reformë, e cila do t'i shërbejë një ndarje më të mirë të fondëve si dhe krijimin e kushteve për investime reale apo dhe mirëmenaxhim të turizmit. Tashmë parlamenti do të nisë me një shkresë të posaçme kërkesën për marrjen e mendimeve prej krerëve të pushtetit vendor. Rezervat pritet të jenë mbi formën e ndjekur për të arritur në bashkimin e zonave apo dhe për ndarjen e kufijve nga situata e mëparshme.

## Vendimi



BRAHIM SHIMA  
TIRANE

Ndarja territoriale me 39 njësi vendore, dhe duke shtuar fraksione të kalimit me 47 bashki mbetet varianti që do të kalojë për votim në parlament. Komisioni për Reformën Territoriale të Shqipërisë ka mbyllur votimin, duke kaluar në fazën e konsultimeve në terren. Me konsensus deputetët e mazhorancës kanë përjashtuar propozimet me 30 njësi zgjedhore 57 dhe me 63 njësi. Gjithsesi projekti nuk do të çenojë sistemin elektoral apo dhe Kushtetutën. Ashtu si dhe u shpreh ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, për të realizuar ndryshimin e funksionit të qarqeve do të duhen mbi 93 vota. Duke parë se për këtë duhet konsensusi i opozitës është kërkuar që kjo të kalojë në një diskutim të dytë. Ndaj dhe është propozuar vetëm kufizimi i numrit të qarqeve dhe jo të funksionit të këtyre njësisë, edhe pse roli i qarqeve deri më tani rezultoi në dështim. Vetë reforma konsiderohet e plotë duke parë se roli i pushtetit vendor është rishikuar në mënyrë të plotë.

### PËRPLASJA ME ZGJEDHJET

Ndarja e re territoriale nuk do të ketë ndikim në ndryshimin e ZAZ apo dhe të Kodit Zgjedhor. Megjithatë në njëfarë mënyrë dhe reforma e bashkive sjell dhe preken e sistemit elektoral. Por që për ministrin Çuçi dhe kjo kërkon një rishikim të Kodit Zgjedhor, e cila mbetet në një diskutim me përfaqësuesit e opozitës. Ndaj dhe konceptimi i ndarjes së re territoriale do të mbetet në kuadrin e menaxhimit të ekonomisë dhe të mirë-

# Shqipëria kalon me 39 njësi zvogëlohet territori i Tiranës

## Detyrat e komunave do të realizohen nga punonjësit

**Çuçi**  
Nuk i kemi vota për ndryshim të Kushtetutës mbi qarqet, kërkohet konsensusi i opozitës



**Oponenca**  
Fino fton opozitën të bëhet pjesë e diskutimit. Debat mbetet në fund të legjislaturës

menaxhimit të fondeve. Përsa i përket largimit të shërbimeve që ofronin komunat, kryetari i Komisionit, Bashkim Fino u shpreh se ky koncept nuk do të preket. Pasi do të vijojnë shërbimet që i kishin në dorë komuna. Në variantin e ri do të jetë kreu i bashkisë që do të ketë të dërguarit e tij, apo të mandatarit për të realizuar këto detyrime.

### ZONAT PROBLEMATIKE

Dy zona janë parë me rezerv nga anëtarët e komisionit në propozimin e ardhur nga qeveria. Varianti që e ndan Shqipërinë në 39 zona zgjedhore, ka marrë mbështetjen e plotë nga anëtarët, por duke kërkuar rishikimin e Himarës si dhe të Tiranës. Ka qenë Blendi Klosi i cili shpreh rezervat mbi Tiranën si një superbashki. Ndaj duke parë se kufijtë e rinj propozojnë përfshirjen e rreth një të tretës së banorëve të Shqipërisë, është kërkuar një ngushtim i propozimit. Ndaj dhe mendimi i tij është përfshirë në draftin e miratuar prej komisionit. Ashtu si dhe kërkesa për shmangien e një teorie të bashkisë etnike.

### FTESA

Anëtarët e komisionit kanë bërë ftesë partive të opozitës të shprehin mendimin e tyre mbi hartën e re territoriale. Madje, Fino theksoi se përgjatë këtyre ditëve ka pasur komunikim me të zgjedhurit vendor të PD, mbi formën e propozuar. Ftesë e cila pritet të mbetet sërish pa përgjigje deri në fundin e kësaj legjislatore. Kohë kur opozita duket se do të shprehë dhe kundërshtimin e saj, jo vetëm për shkak të diskutimit të njëanshëm, por dhe prej parimit të vendosjes së të drejtës së vetos në seancë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMEVE



## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit:

"Sigurimi i jetës dhe kujdesi shëndetësor për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i Hapur Kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 23.004.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: ish-Hotel Dajti, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 04 22 35 576, çdo ditë nga ora 10.00 - 13.00, nga çdo person i autorizuar me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 2.000 lekësh, në Sektorin e Financës të Bankës së Shqipërisë, që ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla B.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **13 Qershor 2014, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Sheshi "Avni Rustemi", Nr 24, Tiranë. Tel: +355-4-241 9301/02/03, +355-4-241 9409/10/11,  
Faks: +355-4-241 9408  
e-mail: public@bankofalbania.org  
www.bankofalbania.org

## » EKSKLUZIVE

**KOMPANIA** konçensionare që duhet të dorëzonte naftën bruto ka abuzuar me 133 milionë lekë vetëm në 1 muaj

# Ujë në vënd të naftës kështu u vodh Albpetrol në ditët e zgjedhjeve

Zbulohet supermashtrimi, prokuroria po heton




### Hetiemt

ELTON QYNO  
TIRANE

**S**kandali i mbushjes me ujë të katër rezervuarve të naftës në kompaninë "Albpetrol", është bërë objekt hetimi në prokurorinë e Fierit, e cila tashmë ka nisur hetimet duke marrë në pyetje disa persona. Ka qënë një kallëzim i ndërmarrjes "Albpetrol" i firmosur nga drejtori aktual Endri Puka, i cili bashkëgjytor me kallëzimin i ka vënë në dispozicion prokurorisë së Fierit, dhe letërnënës dhe shkruar nga përgjegjësi i sektorit të naftës në Zharrës, Përparim Braçe. Të kontaktuar me telefon nga "Shqiptarja.com" zyrtarë të prokurorisë së Fierit, thanë se gjithçka ka ndodhur në kohën e pas fushatës elektorale në Korrik. Përgjendrimi i vëmendjes së drejtuesve të institucioneve në rezultatit e zgjedhjeve elektorale, i ka dhënë mundësi disa personave që të futin katër autobote të mbushur me ujë në stacionin e Zharrës, duke i shkarkuar në katër rezervuarë. Aktualisht hetimi është përqëndruar në identifikimin e personave përgjegjës të këtij megamashtrimi, që është kryer në ditët e fundit të qeverisë Berisha. Sipas burimeve të dyshuarit kryesorë të këtij skandali, janë ish-drejtori i Përgjithshëm i "Albpetrol", Ferdinand Murati, Medi Mol-lasi, Agron Alicena, Xh.Rapaj dhe dy shoferët Andon Daja dhe Xhezmi Bushin.



Ish-Drejtori i Përgjithshëm i "Albpetrol", Ferdinand Murati



Gjykata e Fierit

### Kryesia

Përgjendrimi i vëmendjes së drejtuesve të institucioneve në rezultatit e zgjedhjeve elektorale, i ka dhënë mundësi disa personave që të futin katër autobote të mbushur me ujë në stacionin e Zharrës

### Abuzim me tonelata naftë

## Në dhjetor 2013, kryetari i PD në Fier Murati u kallëzua penalisht

— Në dhjetor të 2013 Ferdinand Murati, ish-administratori i "Albpetrol" njëherësh kryetari i PD në Fier është kallëzuar penalisht në prokurori, pasi një raport auditit e ka nxjerrë me abuzime të rënda. Nisur nga ky konkluzion, drejtori aktual i kompanisë shtetërore "Albpetrol", Endri Puka, ka kallëzuar penalisht Muratin për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën" dhe "Shpërdorimi i Kompetencave". Rezultatet e kontrollit kanë evidentuar shkelje të shumta, të cilat ngarkojnë zotit Murati me përgjegjësi për veprat penale të sipërcituara. Gjatë kontrollit janë evidentuar mungesa në sasinë e naftës bruto prej 2.965 ton me



vlerë 1.221.580 USD. Diferenca e mësipërme përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik. Për më tepër zoti Murati nuk u është përmbajtur rekomandimeve të lëna nga KLSH për situatën e sipërpërmendur. Kontrolli ka konstatuar abuzime në zbatimin e kontratave të shitjes së naftës bruto pasi është lejuar shitja e mallit në favor të një shoqërie që nuk ka qënë subjekt furnizimi sipas kontratës dhe tenderit të organizuar nga METE. Kësaj shoqërie, në kundërshtim me kontratën, i është lëvruar malli pa kryer pagesën e nevojshme në një kohë kur kontrata kërkonte që malli të parapaguhej ose të garantohej pagesa e tij nga sistemi bankar.

### SEKUESTRO DOKUMENTAVE

Prej disa kohësh prokuroria e Fierit, ka sekuestruar dokumentacionin që është mbajtur nga puntorët e stacionit të naftës në Zharrës të Fierit, ku tregohet prania e katër autoboteve të mbushur me ujë. Sipas burimeve pranë kësaj prokurorie, gjithçka është shënuar në letër por askush nuk ka vepruar për të ndaluar

mbushjen e rezervuarëve të naftës me ujë. Këto manovra i kanë interesuar dikujt. Nisur nga kjo situatë, prokuroria e Fierit disa kohë më parë ka thirrur për të dëshmuar disa prej ish-zyrtarëve të kompanisë shtetërore të naftës

"Albpetrol". Nga ana e saj, prokuroria e Fierit shpreh se hetimi i kësaj çështje është prioritet, dhe se nuk mund të japin shumë detaje lidhur me veprimet hetimore që janë kryer gjatë kësaj kohe. Parvarësisht kësaj, burimet shtetërore

mbushjen e rezervuarëve të naftës me ujë dhe mbi disa kompani private konçesionare, që duhet të dorëzonin naftën tek kompania shtetërore "Albpetrol". Një gjë e tillë nuk ka ndodhur kurrë pasi në vend të naftës, pikërisht këto kompani kanë

### DËSHMIA TRONDITËSE

## Braçe: Nga Visoka, erdhi 1500 metër kub vetëm ujë

— Në letërnënës të tij Përparim Braçe shkruan se: "...Nga Visoka për në Zharrë për muajin Korrik kanë ardhur 1155 m<sup>3</sup> = 1140 ton. Nga ky produkt që erdhi 1500 m<sup>3</sup> ishin ujë dhe 60 m<sup>3</sup> u hodhën te R 8 nga evadimi i R 1 që kishte 2 vjet pa evadim dhe që ishte këputur gjuhëzi i saraqineskës. Nafta që ka ardhur nga Visoka përqindja e ujit ka qënë më e madhe se e shkruar në dokument dhe këtë shqetësim e trajtova me shefin..." E gjithë kjo praktikë tashmë është në fazën e verifikimit të plotë nga prokuroria e Fierit. Organi i akuzës mësohet se i ka kërkuar dhe bashkëpunim ndërmarrjes shtetërore "Albpetrol", për të zbuluar megamashtrimin.


Verifikime janë duke u kryer dhe për sa i përket zbulimit të autoboteve, ku janë kontrolluar targa të tyre, por për këtë pjesë prokuroria nuk pranon të flasë dhe të japë detaje të shumta se kush prej kompanive konçesionare i përkasin katër autoboteve që kanë shkarkuar gjatë muajit Korrik, ujin në rezervuarët e naftës.

hedhur në rezervuara sasi të konsiderueshme me ujë. Ndërkohë që dëmi financiar për këtë rast llogaritet në mbi 133 mln lekë, duke marrë parasysh vetëm mungesën e 332 metër kub naftë në muajin Maj, pa llogaritur dëmin e shkaktuar nga shkarkimi i katër autoboteve me ujë në rezervuare. Muaji Qershor ka nisur me bilanc minus prej 332 metër kub.

### KU SHKON NAFTA?

Manovrat e kryera nga kompanitë konçesionare, duke mashtuar "Albpetrol"-in, nuk janë të rastësishme. Në shumë raste përdoret

praktika e shumave financiare nën dorë, dhe për pasojë në vend të naftës që duhet të dorëzohet kompanitë konçesionare në "Albpetrol", për disa puse që ky i fundit jep me qera shfrytëzimi, dorëzohet ujë ose produkte të tjera që nxiren nga pusët. E gjithë kjo skemë mashtrimi është në interes të kompanive konçesionare, të cilat të gjithë naftën e nxjerrë nga pusët, e zotërojnë në rezervuarët e tyre dhe më pas e shesin. Në këtë histori mashtrimi, të fituar janë kompanitë konçesionare dhe drejtuesit e kompanisë "Albpetrol", ndërkohë që dëmi shtetëror është kolosal.



▼ Faksimile e letërës së shkruar nga përgjegjësi i sektorit të naftës në Zharrës të Fierit, Përparim Braçe ku denoncon hetën skandali i mbushjes me ujë të 4 rezervuarëve të naftës

**Dëshmia**  
**ELTON QYNO**  
TIRANË

# Letra që zbulon megamashtrimin, 4 rezervuarë nafte u mbushën me ujë ‘Boti qysh në fillim kishte ujë por shefi tha vazhdo shkarkimin’

## Kush fshihet pas boteve që shkarkuan ujin si naftë në depozitë

**N**jë letër që hedh fakte tronditëse e shkruar nga stacioni i ndërmarrjes “Albpetrol” në Zharrës të Fierit, i ka hapur rrugë një hetimi, që ende nuk ka arritur të nxjerrë në dritë përmasat e këtij skandali. Cisternat e “Albpetrolit” në stacionin e naftës në Zharrës janë mbushur me ujë gjatë muajit korrik, pikërisht në periudhën e pas zgjedhjeve elektorale ku ende numëroheshin utitë e votimit. Ish-kasta drejtuese e ndërmarrjes “Albpetrol”, ka ditur gjithçka për këtë mashtrim e kryer nga një kompani private. Megjithatë janë sinjalizuar për këtë skandal, është urdhëruar vijimi i operacionit, duke bërë që katër autobotë me ujë të shkarkohen në rezervuarët R 1, R 8, R 9, R 10. Pikërisht në këto rezervuara është shkarkuar ujë, ndërkohë që është deklaruar se shkarkohej naftë. Autobotet që kanë marrë pjesë në këtë operacion megamashtrimi, janë identifikuar me targat si: AA 045 Ak-AA R139 me shofer Andon Dajën që ka ardhur nga Visoka, AA 046 Ak-AAR 138 me shofer Xhezmi Bushin, AA 127 AP-AAR 157 dhe AA 46 Ak-AAR 138. Gazeta “Shqiptarja.com” boton sot të plotë letërnë e përgjegjësit të stacionit të naftës në fshatin Zharrës, ku

tregon me detaje megamashtrimin e bërë në cisternat e “Albpetrolit”. Sipas Përparim Braçes, naftëtarit që prej 24 vjet ushtron detyrën e përgjegjësit të stacionit të naftës në Zharrës, për muajin qershor bilanci është filluar me -332 m3 naftë. Pikërisht kjo sasi nuk ka asnjë adresë se ku mund të ketë shkruar dhe kush ka përfituar nga mungesa e saj. Mirëpo për të mbyllur këtë “gropë” ish-drejtuesit e kompanisë shtetërore “Albpetrol”, kanë vendosur ta zëvendësojnë duke shkarkuar në katër rezervuarë nafte, plot 4 autobote me ujë. Letra që hedh dritë mbi këtë skandal dhe që boton sot gazeta “Shqiptarja.com” është shkruar me shkrim dore nga përgjegjësi i stacionit Zharrës, ku tregohet mashtrimi i bërë dhe mos veprimi ishesht Medi Mollasi, Agron Alicane dhe Xh.Rapaj.

**Mbushja**  
Cisternat e “Albpetrolit” në stacionin e naftës në Zharrës janë mbushur me ujë gjatë muajve qershor-korrik



Këshillit Teknik dhe bilanci vazhdoi me fondacion 289 m3 = 286,11 ton. Për muajin Qershor bilanci është filluar me -332m3. Në muajin Korrik erdhën në Zharrës nga Visoka 1155 m3 =1140 ton por qysh me datën 4 korrik 2013 në orën 11:40 boti me targë AA 045 Ak-AA R139 me shofer Andon Dajën erdhi nga Visoka, u bë kontrolli dhe filloi shkarkimi. Qysh në fillim boti shkarkonte ujë, u lajmërua dispenceri XH.Rapaj dhe shefi zonës Medi Mollasi dhe kryeinxhinieri Agron Alicane më thanë vazhdo shkarkimin dhe boti i parë u shkarkua. Filloi

shkarkimi i botit të dytë AA 046 Ak-AAR 138 me shofer Xhezmi Bushin.... Filloi shkarkimi i botit, prapë ky botë kishte ujë, u lajmërua dispenceri dhe shefi zonës Medi Mollasi. U dha urdhër që të ndale shkarkimi i botëve. Për të dy këta botë që u shkarkuan u mbajtën proces-verbale në prani të operatorëve dhe nd/operatorëve dhe shefit të zonës Medi Mollasi dhe shkarkimi i botëve që ishin në stacion u bë ndalimi i tyre në një urdhër tjetër. Më datën 5 korrik 2013 u dha urdhër në orën 08:30 të vazhdojë shkarkimi i botëve prandaj

dhe për këta botë u bë proces-verbal nga turni që erdhi. Por dhe në datën 12 korrik 2013 prap i njëjti problem me botin AA 46 Ak-AAR 138.... U bë kontrolli dhe filloi shkarkimi. Boti duke shkarkuar kishte ujë u lajmërua shefi Medi Mollasi dhe kryeinxhinieri Agron Alicane dhe për këtë bot u bë proces-verbal. Më datën 20 korrik 2013 vazhdon e njëjta situatë. U lajmërua shefi dhe kryeinxhinieri Agron Alicane dhe u bë proces-verbal. Në datën 23 korrik 2013 u bë evadimi i rezervuarit nr.1 për tek gropa e avarisë nëpërmjet linjës së re dhe kur filloi evadimi për te gropa e avarisë erdhi uji. Për këtë u lajmërua shefi sektorit Medi Mollasi dhe ai dha urdhër të vazhdojë evadimi dhe për këtë rast u mbajt proces-verbal për këtë sasi ujë që u hodh për te R 8. Në datën 24 korrik 2013 vjen nga Visoka boti me targë AA 127 AP-AAR 157,bëhet kontrolli dhe filloi shkarkimi i botit nga grupi i punës. Boti qysh në fillim kishte ujë dhe për këtë u lajmërua shefi Medi Mollasi dhe dispenceri me urdhër të shefit vazhdoi shkarkimin e botit. Për këtë

datë u mbajt proces-verbal. Nga Visoka për në Zharrës për muajin Korrik kanë ardhur 1155 m3 = 1140ton. Nga ky produkt që erdhi 1500 m3 ishin ujë dhe 60 m3 u hodhën te R 8 nga evadimi i R1 që kishte 2 vjet pa evadim dhe që ishte këputur gjuhëzi i saraqineskës. Nafta që ka ardhur nga Visoka përgjindja e ujit ka qënë më e madhe se çshkruhet në dokument dhe këtë shqetësim e trajtova me shefin.... Zoti Drejtor pasqyrt e muajve i bëra për të parë koeficientin e shitjeve që u bë në muajin Nëntor 2013 nga grupi i punës me në krye inxhinierin z.Novrus Cuko dhe veçanërisht R 8 + R9 + R 10 ku u shitën pa qetësuar lëngun. Në sektorin Zharrës për këta 5 muaj u shitën 23000 m3 ku dihen rezervuarët R 7 + R 6 janë të hapur, janë jashtë kushteve teknike ku në këtë produkt që është shitur nuk njihen as firo transporti as avullimi. Produkti i ardhur tek rezervuari nr.6 ka ardhur qysh në vitin 2012 në Janar-Shkurt. Prandaj kërkohet që kjo padrejtësi të shikohet dhe të ballafaqohet të jem edhe unë si përgjegjësi i këtij 6-mujori.

**Bilanci**  
Sipas Braçes, naftëtarit që ushtron detyrën e përgjegjësit të stacionit të naftës në Zharrës, për muajin qershor bilanci është filluar me -332 m3 naftë

# » CELULA

**KOMUNIKIMI, armët janë të kalbura do t'i hidhnim.**  
Publikohet i plotë përgjimi ambiental pas kontrolleve në dy banesa në Peqin, ku janë kapur armë dhe municione.

## Ngjarja

### → PRILL 2013

**1** — Pikërisht në këtë muaj në Elbasan kanë nisur hetimet për "Trafik të veprave të artit", që tregonin për trafikimin në Maqedoni të rreth 16 pistoletave të vjedhura në muzeun e qytetit të Elbasanit.

### → DHJETOR 2013

**2** — Në këto muaj, është vendosur të ndërhyhet për të kontrolluar banesat e tre personave. Gjatë hetimeve ishin regjistruar biseda telefonike, që tregonin interesimin e personave për dërgimin e rekruteve në luftën Siriane.



### → MARS 2014

**3** — Ky muaj shënon finalizimin e operacionit për arrestimin e celulës muxhahidiste në Tiranë dhe Elbasan. Hetimet e Krimeve të Rënda, kishin marrë spunto nga disa përgjime të kryera nga prokuroria e Elbasanit.



# Përgjimi, bileta për Siri e kërkesa për 1 muaj punë andej


Dyshimi se mos përgjoheshin nga çimkat e futura në qeli dhe deputeti i zonës Qifi. Biseda e plotë

ELTON QYNO  
TIRANE

**T**eksa prokuroria dhe policia e Elbasanit ushtrojnë kontrolle në dy banesat e të dyshuarve për akuzën e "Trafikimit të veprave të artit" Gerti Pashja dhe shtetasit Aertil Met'hasani, në banesat e tyre janë gjetur disa armë si, pushkë, automatik kallashnikov dhe disa plumba e municione të tjera. Fill pas këtij konstatimi, janë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Elbasan dy

shtetasit Erjon Met'hasani dhe Bardhyl Met'hasani, të cilët janë futur në një dhomë shoqërimi dhe me urdhër të prokurorit janë përgjuar në mënyrë ambientale. Në bisedat mes Erjonit dhe Bardhytit që në përgjim identifikohen me inicialet "E" dhe "B", tregohet prania e disa armëve të vjetra e të kalbura, të cilat sipas tyre ata i kishin për t'i hedhur. Ndërkohë gjatë bisedës flitet për një çantë që kishte mbetur në makinë, ku brenda çantës ndodhej një biletë. Erjoni i thotë Bardhytit se: "Nuk i bie siraia je shku më anej jo". Më pas Bardhyli, i përgjigjet për ku do

shkonte, por ai i thotë në Itali. Më tej përgjimet që "Shqiptarja.com" publikon tregojnë bisedën që i kishin kërkuar të atit që të shkonte të punonte një muaj andej dhe të kthehej për festa. Gjatë përgjimit është folur dhe për deputetin e zonës, Qifin, si dhe dyshimet se mos përgjoheshim me çimka. Opgj i fut të shoqëruarit në një dhomë shoqërimi, ku pasi i pyet për gjeneralitetet largohet duke i lënë të lirë në bisedë të lirë me njëri-tjetrin. Dëgjohej të lutura për Allahun nga Erjoni në dhomën e shoqërimit. Dëgjohej lëvizje në dhomën e shoqërimit.



Faksimile e procesverbalit që lejonte përgjimin ambiental në ambientet e drejtorisë së Policisë së Elbasanit

## PERGJIMET

- **B:** Hë?
- **E:** Hë
- **B:** E?
- **E:** Po ti këtu qënke?
- **B:** E!
- **E:** Ça po bën ti po falesh?
- **B:** Mirë tha ty do të marri emër mbiemër e do ikësh tha.
- **E:** Eeee
- **B:** Po shenjash gishtash të morën ty?
- **E:** Jo
- **B:** E...!
- **E:** Pauzë. Dëgjohej frymëmarrje të thella në dhomën e shoqërimit.
- **E:** E pikë e zezë! (Dëgjohej të trokitura në dhomën e shoqërimit)
- **B:** Kësaj i thonë
- **E:** Kot fare
- **B:** Kot fare po
- **E:** Mos or Zot, mos or Zot
- **E:** Të vish për hall.Pf..!Një qerre problem e kur vjen puna, mos or zot!
- **E:** Ç'të bëjmë tashi të presim avokatit të shofim. Të flasim me një avokat.
- **B:** E...?
- **E:** A të flasim me një avokat, e basta. (Pauzë). Do vij prokurorit thonë këto.
- **B:** Eh p Zot, ato s'deshën lënë fare

- mrena o vlla, s'është shpia e Tilit, këto ene pikë mbaroi, ai llafe. Do i them unë avokatit, po ajo është shpia ime o vlla, ç'të drejtë kanë ata të hynë?
- **E:** Kanë pasur urdhër
- **B:** E...?
- **B:** Po s'është shpia e Tilit, e kanë pas për ke shpia e Tilit. Ku e ka shpinë Tili? Në Durrës.
- **E:** Eh tashi iku ajo punë
- **B:** Ti them avokatit o vlla
- **E:** E...?
- **B:** Ti them avokatit. Kanë hy në shpi teme padrejtësisht.
- **E:** Hajde gjeje
- **B:** Më pyetën ke armë? Ja dorëzo-va. Ti them unë kaq do i them nuk e di.
- **E:** E quajnë, armëmbajtje pa lejë
- **B:** Po mirë mo burrë
- **E:** Po i thashë unë, ato janë hekurishte mor ti thash, ç'a jeni duke bob re i thash e është turp thash, janë hekurishte për t'u hudh.
- **B:** I prodho tha.
- **E:** S'dihet se kush i ka fut, e ç'arë është bërë aty.
- **B:** Ptttyy..!
- **E:** Unë me zor po prisja të shifja Sarën, ëj bel
- **B:** E...E...

- **E:** Uff!
- **B:** Robt po vrasin, po presin dhe rrinë rrugëve
- **E:** Eh!Ato si gjen gjë
- **B:** E?
- **E:** Ato, hekurishte të kalbura, puuuuff!O Zot!
- **E:** S'e kuptoj pse të lanë ty këtu hë?
- **B:** E...
- **E:** Pse të kanë këtu ty me mua? Pse të lanë këtu me mua them?
- **B:** Ku di di gja unë. (Pauzë). Mos kan fut çimic.
- **E:** E...?
- **B:** (Qesh). Mos fut noj çimic
- **E:** Eee!
- **B:** E...?
- **E:** Se di o vlla
- **B:** Këto janë bastarda ore. Rim këtu kot
- **E:** Po mirë o vlla, studjohet tjetri, ç'a familje është, çar ka bo e çar s'ka bo, e ç'a o Zot thuaj, o Zot thuaj.
- **B:** Ti kot erdhe, di gjë unë o vlla, ç'punë kishin me ty ato.
- **E:** E o zot i madh thuaj.
- **B:** Hë ti ke ardhur kot, për ç'a duhet të vije ti këtu e morra vesh?
- **E:** E...

- **E:** S'kemi as ndonjë orë. As ti s'ke orë?
- **B:** Jo, e cuk, cuk! Pfff! gjë hijç
- **E:** Ba unë jam pa gjumë
- **B:** E?
- **E:** E...?
- **B:** Dy ditë rrugëve ç'a do ma ti
- **E:** Dy ditë rrugëve edhe pothuajse sonte tre net pa gjumë
- Dëgjohej frymëmarrje të thella në dhomën e shoqërimit. Dëgjohej lëvizje në dhomën e shoqërimit. Dëgjohej psherëtim. Bisedë për dhomat e shoqërimit. Bisedë për të kryer nevojat personale.
- **E:** Apo s'më nalovi barku në autostradë kur erdhëm për këtë
- **B:** E!
- **E:** Ha, ato paninet rrugës, pff, ene më dhemb dhe barku, hajde gjeje këtë punë.
- **E:** Po çantën time e zbritte nga makina ti apo jo?
- **B:** E...?
- **E:** Çantën time, e zbritte nga makina?
- **B:** Jo
- **E:** Kujt ja dhe ti çelësat e makinës Fatit?
- **B:** Titit

- **E:** Kujt, kujt do ja japi atëherë?
- **B:** Arjanit
- **E:** Ej po është çanta ime me, me plaçka ore
- **B:** Po s'lu njeri jo
- **E:** Kam biletën ee... Megjithëse si bie siraia me shku ma anej jo
- **B:** Ku?
- **E:** Në Itali
- **B:** Pse
- **E:** Ah, ku meret vesh tashi
- **B:** Po, jo re
- **E:** Ehhh!
- Bisedë për punonjësit e policisë. Bisedë që i kishte kërkuar të atit të shkonte të punonte një muaj andej dhe të kthehej për festa. Bisedë që ky vënd nuk është i mallkuar. Bisedë për deputetin e zonës, Qifin. Bisedë për orën. Bisedë për prokurorin. Dëgjohej frymëmarrje të thella në dhomën e shoqërimit. Luten tek Zoti

**FUTET NJË OPGJ. MBYLLET VEPRIMI**  
Dëgjimi e Transkriptimi i bisedave u krye në Zyrën e Seksionit të Teknologjisë dhe Përgjimit Ambiental nga datë 5 dhjetor 2




# Dosja, gjykata dënoi me 2 vite burg Pashjan e Erjon Met'hasani


## Materiali hetimor që nisi për trafik e u mbyll për armëmbajtje pa lejë

ELTON QYNO  
TIRANE


Një javë më parë gjykata e Elbasanit mbylli procesin gjyqësor kundër Isuf Pashja, babait të Gerti Pashjas të arrestuar së bashku me 12 persona të tjerë në Tiranë, si dhe shtetasit Erjon Met'hasani, duke i dënuar këta të fundit me nga 1 vit burg për akuzën e "Prodhimit dhe mbajtjes pa lejë të armëve luftarake dhe të municionit". Në vendimin e saj gjyqtarja Pajtime Fetahu, deklaroi fajtorë Met'hasanin dhe Pashjan, duke i dënuar me dy vjet burg së bashku. Gjatë fazës së gjykimit në gjykatën e Elbasanit, dy të pandehurit pranuan se armët ishin të tyre dhe mbaheshin në banesë që nga viti 1997. Ata kërkuan gjykim të shkurtuar, kërkesë kjo që është pranuar nga gjykata, duke sjellë dhe uljen e masës së dënimit me 1/3-ën. Erjon Met'hasani dhe Isuf Pashja, pohuan se armët i mbanin të fshehura në shtëpi, por në fakt nuk i kanë përdorur në asnjë moment për t'i bërë keq njeriu.



Faksimile e ekstraktit të Gjykatës së Elbasanit



**Bisedat**  
Gjatë përgjimit është folur dhe për deputetin e zonës, Qifin, si dhe dyshimet se mos përgjoheshim me çimka. Opgj i fut të shoqëruarit në një dhomë shoqërimi, ku pasi i pyet për gjeneralitetet largohet duke i lënë të lirë në bisedë të lirë me njëri-tjetrin.



**HETIMI**  
Personat e dyshuar dhe që janë mbajtur në vëzhgim me urdhër të prokurorit Bledar Mustafaraj, kanë qënë shtetasit maqedonas, Edip Kurtishi, Minir Osmani dhe shtetasit shqiptarë Emir Bego me pseudonimin "Rambo" nga Cërriku, Gerti Pashja, Sazan Hoxha, Artil Met'hasa, Artur Korra dhe Erzen Gashi. Nga bisedat e përgjuara mes këtyre personave dhe Gerti Pashjas, janë interceptuar komunikime që tregojn interesimin për rekrutimin e personave dhe dërgimin e tyre në Turqi dhe më pas

**Shtator 2013**  
Pikërisht në këtë kohë prokuroria e Elbasanit ka vendosur që procesverbalet e përgjimeve që flitej për rekrutimet në Siri, t'ia kalojë për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Krimeve të Rënda

**Al-Nusra**  
Hetimet për zbulimin e plotë të celulës muxhahedine në Tiranë dhe Elbasan, janë kryer nga SHISH e Krimet e Rënda, të cilat arrihen të identifikojnë personat që çonin shqiptarë për të luftuar përkrah Al-Nusra

në luftën e Sirisë, duk ju bashkuar grupit terrorist "Al-Nusra". Dyshimet flasin se armët e trashëgimisë kulturore do shiteshin në Maqedoni, ndërkohë që pas kontrollit në banesa nuk janë gjetur armë të vjetra, por armë luftarake si pushkë dhe kallashnikov dhe municione. Gjatë kontrollit të banesave

në Peqin, policia ka shoqëruar Isuf Pashjan dhe Erjon e Bardhyl Met'hasanin. Në fund të hetimeve, është ngritur akuzë vetëm për shtetasit Isuf Pashja dhe Erjon Met'hasani, duke i dërguar si të pandehur në gjykatë. Një javë më parë ata janë shpallur fajtorë, duke u dënuar me 1 vit burg secili.

### LAJME shkurt



#### Djali i Azem Hajdarit, 3.1 mln faturë telefoni

Kirjald Hajdari, djali i "Heroit të Demokracisë" Azem Hajdari refuzon të paguajë faturën prej 3.1 milion lekë tek kompania telefonike "Albtelecom". Nisur nga kjo situatë, kompania në fjalë është drejtuar gjykatës së Tiranës me një kërkesë padi ku kërkon përmbushje detyrimi kontraktor, duke paguar vlerën e faturave telefonike në shumën 320,197.51 lekë si dhe kamatat ligjore. Aktualisht kërkesë padia do gjykohej nga gjyqtarja Elona Stavri. Procesi gjyqësor do zhvillohet pikërisht në gjykatën e Tiranës, aty ku punon si gjyqtare dhe gjyqtarja Fatmira Hajdari, që është e ëma e Kirjald Hajdarit.



#### Bujar Nishani, gjyqtarëve: Izoloni korrupsionin

Presidenti Bujar Nishani ju drejtua me një apel të fortë profesionistëve në sistemin e drejtësisë dhe vetëm atyre gjyqtarëve që i konsideron si pjesë e shëndoshë që të izolohen të korrupuarit. "Ka ardhur dita që pjesa e shëndetshme e sistemit të drejtësisë të veprojë aktivisht dhe të bëhet model orientues e përgjues në veprimtarinë e përditshme të sistemit të drejtësisë duke izoluar çdo ditë e më shumë modelet e korrupsionit dhe mungesës së profesionalizmit. Po ashtu, ka ardhur dita që fjalë kyçe në veprimtarinë e përditshme duhet të jetë gjithëpërfshirja" - theksoi zoti Nishani. Për presidentin, problemi me korrupsionin në drejtësi është vetëm një nga shqetësimet e saj.

**Trafiku**  
**ARTAN CENA**  
TIRANE

# Aksioni nga Policia e Ekuadorit në portin e Guayaquil 89 kg kokainë do vinin drejt portit të Durrësit Droga e fortë ishte maskuar si ushqim për qentë

**S**ekuestrohen 89 kg kokainë në Ekuador që kishte destinacion portin e Durrësit në Shqipëri. Lajmi i është bërë i ditur nga Ministria e Brendshme e shtetit të Amerikës Latine, sipas së cilës, droga është gjetur gjatë operacionit të koduar "Arcano" në një kontener që ishte i mbushur me ushqim për qentë dhe që kishte destinacionin Durrësin. Operacioni është bërë një ditë më parë nga efektivet e sektorit kundër Narkotikëve në qytetin e Guayaquil. Në pranga është vënë një person me të dhënat, L. Homar.

**KONTROLI NË PORT**

Shefi i Narkotikëve, Omar Baez Paredes ka bërë të ditur se, agjentët e njësive së tij me anë të qenve nuhatës të drogës gjatë një kontrolli në kontenerët, një njërin prej tyre është gjetur dhe lënda kokainë. Ajo ishte fshehur në një fund të dyfishtë në kontenerin TRIU me numër 8498675. Kokaina ishte e



Konteneri ku u gjet lënda narkotike

ndarë në 80 pako. Policia ka arrestuar disa persona ndërsa bëhet e ditur se është shkatërruar një rrjet i trafikut të lëndëve narkotike. Sipas

policiës, anija do të nisej nga Guayaquil dhe pas disa ndalesash do të përfundonte në Shqipëri ku edhe ishte një pjesë e ngarkesës.

**Aksioni**

89 kg kokainë është sekuestruar ditën e djeshme në portin e Guayaquil në Ekuador, duke u arrestuar edhe disa persona. Droga kishte destinacion Shqipërinë.

**HETIMET E POLICISË**

Zbulimi i lëndës narkotike që ishte fshehur në kontener, duke se ishte zbuluar pas një informacioni të ardhur në rrugë operative. Kjo pasi policia ka falenderuar qytetarët për informacionet që japin për trafikun e lëndëve narkotike. Lënda narkotike kokainë, ishte e vulosur si ushqim për qentë bulldogë dhe St. Bernard dhe

ishte e veshur me një letër të veçantë për të mos u dëmtuar. Policia tha se, këtë herë rrjetet e drogës kanë duke përdorur prodhime ekuadoriale për të bërë trafikun.

**TRAFIKU I DROGËS**

Lënda narkotike mësohet se, do të ngarkohej në anije për të arritur në tregjet ndërkombëtare në Europë. Po siç duket destinacioni i parë do të ishte porti i Durrësit në Shqipëri dhe më pas do të shitej në vende të tjera. por droga ishte zbuluar nga kontrollat e policisë së Ekuadorit. Konteneri gjendej në port dhe është zbuluar para se të imbarkohej në anije. Ministria e Brendshme e Ekuadorit ka bërë të ditur se, është duke vazhduar operacionin për zbulimin e origjinës së kësaj droge.

**ITALI**

## Gjenden 1.5 ton kanabis i braktisur

Autoritetet italiane kanë kapur dhe sërish 1.5 ton drogë duke e çuar në 3 ton marijuanën e sekuestruar gjatë patrullimeve në det. Në fakt është mbi 1.5 ton marijuanë sasia e sekuestruar sot nga ana e Gurdia di Finanza në Ciro Marina. Njëسيا detare ka identifikuar një motoska që ishte drejtuar drejt brigjeve Kalabrese dhe është vënë në ndjekje të tij, për ta kontrolluar. Sapo kanë parë policinë, trafikantët kanë braktisur drogën menjëherë dhe janë futur në ujërat ndërkombëtare. Në operacionin për ndalimin e motoskaftit dhe sekuestrimin e drogës është bërë në bashkëpunim të autoriteteve detare të Barit dhe Tarantos.

# Vrasja në '99 sillet nga Italia i dënuari, Ndreca

I dënuari akuzohet se, në shkurt të vitit 1999 ka bashkëpunuar në vrasjen e Manil Likës

**Ekstradimi**  
TIRANE

**E**kstradohet nga Italia Fran Ndreca, i dënuar me 20 vite për vrasje të ndodhur në 16 shkurt të vitit 1999. Ndreca akuzohet se, kishte bashkëpunuar në vrasjen e Manil Likës, e ndodhur në rrugën Mine Peza në Tiranë pranë lokalit "Forial". 41-vjeçari, nga fshati Kojanë i Mirditës, është sjellë në Tiranë nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, nga Milano ku ai ishte arrestuar dhe ka vuajtur një tjetër dënim, edhe këtë herë për një vrasje të bërë në vitin 1998. Ndreca është dënuar në vitin 2005 me 20 vite burg. Në dosjen e tij, thuhet se, Fran Ndreca ka qenë shok me P. M., i cili e ka vuajtur dënimin. Në datën 16 shkurt 1999 rreth orës 11.30-11.45 i pandehuri është takuar me shokun e tij dhe kanë shkuar në rrugën



**Zënka**

Shërr mes viktimës dhe dy të dënuarve kishte nisur para vrasjes. Ditën e vrasjes njëri nga autorët i ishte drejtuar Likës: "...A të kam thënë mos të qëndrosh apo të hysh herë tjetër këtu...?"

"Mine Peza" në bar "Forial" ku kanë porositur kamarieren një teke "Whiskey" dhe një çaj. Në këtë kohë përpara lokalit ka kaluar me makinë viktimja Manil Lika. Viktimja është afëruar tek dera e lokalit dhe i

ka kërkuar kamarieres të dilte jashtë dhe ajo ka dalë. Nga tavolina është ngritur njëri nga personat dhe i ka thirrur viktimës të ndalonte një moment. Viktimja Manil ka ndaluar, ka pritur sa është afëruar Petriti tek ai, për ta dëgjuar çfarë kishte. "...A të kam thënë mos të qëndrosh apo të hysh herë tjetër këtu...?" Viktimja ka reaguar negativisht. Kjo ka mjaftuar që ata të acaroheshin skajshëm me njëri-tjetrin. Ata e kishin lënë që të takoheshin më vonë. Sipas dosjes, mes viktimës dhe dy personave të dënuar ka pasur një marrëdhënie të acaruar nga më parë. Kur Manil Lika ishte rikthyer, i dënuari Ndreca dhe shoku i tij e kanë kapur dhe e kanë qëlluar dy herë në kokë dhe 3 herë në trup me një pistoletë TT, duke i marrë jetën menjëherë. Që në atë kohë, të pandehurit ishin larguar për t'u arrestuar më pas e për të vuajtur dënimin. Interpol Tirana në bashkëpunim me Interpol Romën, e kanë sjellë 41-vjeçarin në Shqipëri. Ai u është dorëzuar përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët e kanë çuar në qeli.

**Pjesë e Grupit ProCredit**  
Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

**ProCredit Bank**

**Bankat ProCredit të Ballkanit dhurojnë 550'000 euro për zonat e prekura nga përmbytjet në Bosnje-Hercegovinë dhe Serbi**

*"Neighbour to neighbour" (Fqinj për fqinjin) – Iniciativa e realizuar nga Bankat ProCredit.*

Sot, Bankat ProCredit të Shqipëri, Bullgari, Kosovës dhe Maqedonisë së bashku me ProCredit Bank në Bosnje-Hercegovinë dhe Serbi kanë dhuruar një fond prej 550'000 Euro për zonat e prekura nga përmbytjet në BiH dhe Serbi. Ky fond do të kanalizohet nëpërmjet iniciativës "neighbour to neighbour", të krijuar nga këto gjashtë banka. ProCredit Bank në Serbi dhe BiH do të shpërndajnë fondet e dhuruara në formën e ndihmave humanitare si: medikamente, materiale higjieno-sanitare, ujë dhe ushqime, si dhe materiale të tjera ndihmëse në zonat e prekura.

Në Serbi, Ministri i Infrastrukturasë tha se 3'500 km rrugë janë shkatërruar dhe 30% e linjave hekurudhore kanë dalë jashtë funksioni. Në Bosnje, autoritet kanë identifikuar mbi 4 milion banorë të prekur nga këto përmbytje që mbuluan më shumë se ¼ e territorit të Bosnje-Hercegovinës. Rreth 100'000 shtëpi dhe 230 shkolla janë shkatërruar.

"Ne shpresojmë që ndihmat humanitare do të arrijnë sa më parë tek ata që kanë nevojë. Në falënderim bankat ProCredit për mirëkuptimin dhe përkrahjen e këtyre njerëzve të prekur nga përmbytjet. Ne fillimisht do të fokusohemi në ndihmat mjekësore", tha Edin Hrnjica, anëtar i Bordit Drejtues të ProCredit Bank BiH.

NEIGHBOUR TO NEIGHBOUR  
SOLIDARITET PËR SERBINË DHE BOSNJE HERCEGOVINËN

"Çdokush prej vendeve tona mund të ndodhet në një situatë të tillë të paparashikuar. Si pjesë e një Grupi ndërkombëtar, ne ndiejmë përgjegjësinë për të kontribuar sado pak në ndihmë të fqinjëve tanë", tha Adela Leka, përfaqësuese e Bordit Drejtues të ProCredit Bank Shqipëri.

ProCredit Bank Shqipëri, e themeluar në vitin 1995, është pjesë e grupit ndërkombëtar ProCredit i cili udhëhiqet nga ProCredit Holding dhe mbështetet plotësisht nga ProCredit Bank në Gjermani. ProCredit Holding dhe ProCredit Bank Gjermani janë të mbikqyrra nga Autoriteti Gjerman i Mbikqyrjes Financiare (BaFin), që thekson besueshmërinë dhe qendrueshmërinë e institucionit ProCredit.

Banka ProCredit sh.a  
Rr. Dritan Hoxha  
P.O. Box 2395  
Tirane, Shqipëri

Tel: +355 / 4 2 389 389  
Faks: +355 / 4 2 389 389  
Info@procreditbank.com.al  
www.procreditbank.com.al

Drejtoria Ekzekutive  
Adela Leka, Violeta Haxhillazi

Vendi i regjistrimit: Tirane  
Nr.Vendimit të Gjykatës:20797/11.0  
KIB: 20911005  
Nipt J 91524011J

# Nis procesi i licensimeve për internetin 4G në telefonat celularë

Të 4 operatorët mund të marrin njëherësh licenca, çmimi parashikohet më i ulët

GENC KONDI  
TIRANE

**S**ë shpejt mund të hapet tenderi për frekuencat e teknologjisë më të fundit për internetin në telefoninë e lëvizshme. Ndryshe nga deri tani, risia është që të katër operatorët e pranishëm në treg mund të marrin njëherësh katër licenca dhe që tarifa që do të kërkojë shteti duket se do të jetë shumë më e ulët se në teknologjinë e mëparshme.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) i ka dërguar tashmë ministres së Inovacionit propozimin për të hapur tenderin e dhënies së frekuencave që do të përdoren për teknologjinë 4G. Pas përfundimit të konsultimit publik, AKEP ka vendosur kushtet dhe procedurat e garës për dhënien në përdorim të brezave të frekuencave 1900-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz, që duhet të marrin miratimin e dikasterit të linjës, për të nisur zyrtarisht prokurimin.

Teknikisht, AKEP vlerëson se për këto breza mund të jepen deri në katër të drejta përdorimi, çka do të garantonte akses në to për të katër operatorët celularë në të njëjtën kohë.

Vlera minimale që do të kërkojë për marrjen e licensave nuk bëhet publike, por dhënia e njëkohshme e katër licensave nënkupton se nuk do të ketë një garë të mirëfilltë dhe shumat e arkëtuara nga shteti nuk priten të jenë të krahasueshme me ato të arkëtuara në kohën e qeverisë Berisha, kur u dhanë licensat 3G, kur nga tre operatorë buxheti i shtetit arkëtoi afro 52 milionë euro.

Plani kombëtar i radiofrekuencave parashikon që brezat në fjalë të përdoren për shërbimet IMT, që i takojnë gjeneratës 4G dhe që garantojnë shpejtësi të internetit dhe transmetimit të të dhënave të cilat teorikisht mund të arrijë deri në 1 Gbps.

Përveç kësaj, AKEP tashmë ka vendosur të ndërmarrë

liberalizim të shërbimeve në të gjitha brezat, çka nënkupton se operatorët do të jenë të lirë të ofrojnë shërbimet dhe teknologjitë që dëshirojnë, pa u kuftuar në kushtet e autorizimit individual. Pra, edhe në brezat që operatorët i kanë tashmë në përdorim, mund të ofrohen shërbime 4G, ndonëse ato nuk mjaftojnë për të përmbushur të gjitha nevojat e operatorëve.

Ndërkohë, ka përfunduar afati që ka vendosur AKEP për regjistrimin e numrave

**Tarifat**  
Shuma e arkëtuar në kohën e qeverisë Berisha kur u dhanë tre licensa 3G, ishin të konsiderueshme. Nga tre operatorë, buxheti i shtetit arkëtoi afro 52 milionë euro

telefonikë celularë. Të gjithë numrat celularë të ndërmarreve, institucioneve apo



grupeve të tjera duhet të regjistroheshin në emër të përdoruesve individualë të tyre deri më 15 maj. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka njoftuar që në muajin shkurt se të gjithë pjesëtarët e grupeve me mbi 20 numra celularë duhet të paraqiteshin pranë

kompanive për të bërë regjistrimin në emrin e secilit abonent. Kjo masë e AKEP erdhi pas kërkesës së Ministrisë së Brendshme, për shkak të problematikës së krijuar në rendin publik nga përdorimi i aparateve celulare për shpërthimet e telekomanduar.

LAJME  
shkurt

## Shumica e bankave me fitim në TR.I

— Njëmbëdhjetë banka e kanë mbyllur tremujorin e parë të vitit me rezultat financiar pozitiv. Sipas të dhënave të paaudituar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, pjesa dërmuese e sistemit bankar përfutteshmërinë, megjithë kushtet sfiduese të tregut. Ndërkohë, tremujori i parë i vitit 2014 ka qenë i dobët për bankat në drejtim të tërheqjes së depozitave nga individët apo institucionet e tjera të biznesit. Depozitat në total për 13 banka që kanë raportuar të dhënat u tritën me vetëm 0.2% në fund të tremujorit të tretë, në raport me dhjetorin 2013.



## Protokoll për turizimin Evropë-Kinë

— Në mjediset e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Hungarisë, Budapest, u inagurua dhe stenda promovuese për Shqipërinë turistike. E pranishme në këtë event ishte edhe ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Eg-lantina Gjermeni, e cila po zhvillon një vizitë dyditore në Republikën e Hungarisë. Ministria Gjermeni nënshkroi në Budapest, gjatë qendrimit të saj, edhe një protokoll bashkëpunimi në fushën e turizmit mes 13 vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Republikës Popullore të Kinës.

## Dogana mbron pronën intelektuale

— Në kuadër të bashkëpunimit me Agjensinë Italiane të Doganave dhe Monopoleve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave organizoi fushatën për Ndërgjegjësimin për Mbrojtjen e të Drejtave Intelektuale. Për herë të parë Dogana shqiptare "zbriti" në mes të fëmijëve përmes aktivitetit të organizuar në shkollën 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe". Deri më tani, janë të mbrojtura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave 276 marka tregtare dhe 10 dizeno industriale.

TAKIMET

## Haxhinasto në forumin e transportit në Leipzig



— Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, mori pjesë në samitin vjetor të forumit ndërkombëtar të transportit, në Leipzig të Gjermanisë. Haxhinasto zhvilloi takim me homologun gjerman Alexander Dobrindt, nga i cili mori mbështetje për bashkëpunimin në reformat dhe zhvillimet infrastruktururore në Shqipëri. Ai u takua edhe me ministrin e Transportit të Katarit, atë turk, homologë të Francës, Britanisë, Kanadasë, Zelandës së Re, si dhe me sekretarin e përgjithshëm të Forumit Jose Veigas.

TAP

Trans Adriatic Pipeline

Trans  
Adriatic  
Pipeline AG

## FTESË PËR PJESËMARRJE NË PARAKUALIFIKIM PËR NDËRTIMIN E TUBACIONIT TRANS ADRIATIK NË SEKSIONIN TOKËSOR NË GREQI DHE SHQIPËRI

Më 10.05.2014, Trans Adriatic Pipeline AG (TAP) publikoi njoftimin e dytë për kontratë për një kontratë madhore Inxhinierie, Prokurimi dhe Ndërtimi në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Kontrata është e disponueshme në faqen e internetit të TAP: <https://www.trans-adriatic-pipeline.com/news/news/detail-view/article/441> ose mund të gjendet drejtpërdrejtë në faqen e internetit: <http://ted.europa.eu/udl?uri=TED:NOTICE:158271-2014:TEXT:EN:HTML>

Objekti i kësaj kontrate përfshin Inxhinierinë, Prokurimin dhe Ndërtimin e përafërsisht 760 km tubacion me diametër 1.2 m (48-inch) që do të përshkojë të gjithë pjesën tokësore në Greqi dhe Shqipëri.

Kompanitë e interesuara për t'u para-kualifikuar për kontratën e ndërtimit të tubacionit në pjesën tokësore, duhet t'i drejtohen TAP për të kërkuar një pyetje **jo më vonë se data 26.05.2014**. Kjo kërkesë mund t'i dërgohet TAP nëpërmjet emailit në adresën [paq.pipecon@tap-ag.com](mailto:paq.pipecon@tap-ag.com). Më shumë informacion jepet në njoftimin për kontratë.

Vetëm një numër i përzgjedhur kompanish të cilat do të kenë kaluar procesin e para-kualifikimit do të ftohen për të pjesëmarrë në fazat e tenderimit të procesit të prokurimit të ndërtimit të tubacionit në pjesën tokësore.

**Vendimi**  
JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANË

Ministria e Mjedisit me 'dorë të hekurt', gjoba deri 1 mln lekë

# "Mjedisi" rrezikon postet e vendorëve

Gjobat do të paguhen nga Kryetarët e Bashkive

Ministria e Mjedisit ka prerë ditën e djeshme gjoba për rreth 90 % të kryetarëve të komunave dhe bashkive në të gjithë vendin për keqmenaxhimin e mbetjeve. Gjobat për krerët vendorë vijnë rreth 2 muaj pas paralajmërimit të ministrit të Mjedisit Lefter Koka, për secilin prej tyre për përmirsimin e situatës mjedisore, në secilin qytet, për rregullimin e menaxhimit të mbetjeve. Në listën e krerëve vendorë të gjobitur nga Ministria e Mjedisit, bëjnë pjesë edhe bashki të qyteteve të mëdha si ajo e Shkodrës, Vlorës, Beratit, Sarandës, Gjirokastrës, Kavajës, Tepelenës, Kamzës dhe Krutës. Ministri i Mjedisit Lefter Koka, ka gjobitur me gjoba nga 500.000 deri në 1 milion lekë (lekë të vjetra), shumta të cilat sipas ministrisë do të rëndojnë drejtpërdrejtë në llogaritë personale të krerëve vendorë. Kështu nga vendorët bien në sy emrat e kryebashkakovëve Shpëtim Gjika, Xhelal Mziu, Stefan Çipa, Gjergj Goro, Elvis Roshi etj. Gjobat për vendorët erdhën menjëherë pas inspektimit të kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Pyjeve i nisur që prej datës 15 prill në të gjithë vendin. Sipas të dhënave të marra nga ky inspektoriat ka rezultuar që



Ministri i Mjedisit, Lefter Koka

pjesa më e madhe e komunave dhe bashkive shkelenin ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane", dhe nuk respektonin rregullat e përcaktuara nga Ministria e Mjedisit. Pjesa tjetër e vendorëve që nuk është gjobitur ka marrë paralajmërim për gjobë apo i janë lënë detyra për t'u zbatuar

për përmirsimin e situatës. Nëse krerët e Bashkive dhe Komunave nuk do të marrin asnjë masë deri në inspektimin e rradhës, ministri Koka ka paralajmëruar se do t'i propozojë Këshillit të Ministrave shkarkimin për secilin prej tyre që nuk i është bindur urdhrave të dhëna nga ministria. Sipas

**Gjobat**

Shumat e vendosura variojnë nga 500 mijë-1 milion (lekë të vjetra), dhe do të rëndojnë në xhepin e vetë vendorëve. Nëse masat nuk do të respektohen ministria do të kërkojë shkarkimin e tyre

këtyj institucioni më shumë se sa gjobën ia ndaj krerëve vendorë, ata rrezikojnë të humbasin detyrat e tyre për shkak të kërkesave që ministria do të bëjë për shkarkimin e tyre nga puna. Prej kohësh ministria e Mjedisit ka dhënë alarmin për gjendjen e mjedisit dhe mënyrën me të cilën institucionet vendorë bëjnë trajtimin e mbetjeve urbane. Në 5 shkurt të këtij viti kjo ministri shpalli edhe emergjencën mjedisore, për të nisur një muaj më vonë inspektimet në të gjithë vendin për të evidentuar vendorët që nuk respektojnë rregullat për menaxhimin e mbetjeve.


**BASHKITE E GJOBITURA NGA MINISTRIA E MJEDISIT**

- Bashkia Shkodër
- Bashkia Tepelenë
- Bashkia Berat
- Bashkia Roskovec
- Bashkia Lushnje
- Bashkia Peshkopi
- Bashkia Burrel
- Bashkia Bulqizë
- Bashkia Kuçovë
- Bashkia Polliçan
- Bashkia Librazhd
- Bashkia Ura Vajgurore
- Bashkia Sukth
- Bashkia Shijak
- Bashkia Manëz
- Bashkia Krujë
- Bashkia Fushë-Krujë
- Bashkia Pogradec
- Bashkia Bllisht
- Bashkia Gjirokastrë
- Bashkia Memaliaj
- Bashkia Këlcyrë
- Bashkia Libohovë
- Bashkia Koplikë
- Bashkia Vau i Dejës
- Bashkia Kamëz
- Bashkia Vlorë
- Bashkia Sarandë
- Bashkia Himarë
- Bashkia Kavajë

LAJME  
**shkurt**

**AKU bllokoi 233 litra vaj jo cilësor**

Pas një kontrolli të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, është bllokuar një sasi prej 233 litrash vaji jo cilësor i cili tregëtohej në mënyrë të paligjshme. Sipas të dhënave të këtyj institucioni ka rezultuar që vaji i bllokuar nuk korrespondonte me atë që shkruhej në etiketat shoqëruese të shisheve plastike me të cilat tregëtohej, duke qenë i përzier. AKU do të vazhdojë aksionin e saj dhe ka paralajmëruar bizneset se për rastet e përsëritura do të ketë edhe mbyllje të subjekteve në fjalë.



**Inagurohet zyra e Punës në Gjirokastrë**

Ministri i Mirëqënies dhe Rinisë, Erion Veliaj ka inaguruar zyrën e re të punës në qytetin e Gjirokastrës. Sipas ministrit ky qytet do t'i rikthehet vëmendjes së qeverisë përsa i përket investimeve dhe kryesisht punësimit të rinjve. Në fund të këtij muaj do të përpilohet një shifër për numrin e saktë të të punësuarve, duke marrë parasysh edhe numrin e bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë qytet.

**Defekti**  
TIRANË

# Uji lë pa shërbim spitalin e Shkodrës

Ndërhyrjet në rrjet lënë pa ujë qytetin. Mjekët duan zgjidhje s'kryejnë operacione

Spitali Rajonal i Shkodrës prej dy ditësh ka anuluar të gjitha operacionet, për shkak të mungesës së ujit në spital. Bluzat e bardha janë shprehur të shqetësuar për situatën, por kanë deklaruar se në mungesë të ujit të pijshëm, nuk mund të realizojnë asnjë ndërhyrje kirurgjikale, madje do të jenë të detyruar edhe të ndërpresin punën në disa pavione të caktuara. Situata është rënduar për shkak të ndërhyrjeve në rrjet nga persona të paautorizuar të cilët kanë ndryshuar skemën e furnizimit në mënyrë të paligjshme. Sipas një deklaratë zyrtare të ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, është njoftuar se qyteti do të ketë mungesë të ujit të pijshëm deri në momentin që në rrjet do të instalohen matësat e ujit dhe të minimizohen ndërhyrjet. Por, ndërkohë në Spitalin Rajonal të Shkodrës, shumë prej qytetarëve të cilët kishin planifikuar të



Spitali i Shkodrës

realizonin operacione janë të detyruar të presin ose t'i drejtohen kryeqytetit për të marrë shërbimin mjekësor. Shqetësimi për mungesën e ujit të pijshëm në spitalin Rajonal të Shkodrës dhe thirrjen për autoritetet vendorë e ka

**Operacionet**  
Prej dy ditësh në Spitalin Rajonal të Shkodrës janë ndërprerë ndërhyrjet kirurgjikale për shkak të mungesës së ujit të pijshëm

bërë publike nëndrejtoresha e këtyj spitali Dhurata Uruçi, e cila krahas lajmërimit për moskryerjen e operacioneve ka njoftuar edhe ndërprejen e diagnostikimit në repartin e neurologjisë. "Uji është kudo i domosdoshëm, por sidomos në spital. Shpresojmë vetëm të mos kemi urgjencë që duan të futen në operacione, pasi nuk do kemi se si t'i kryejmë. Ne duhet të ishim lajmëruar më parë për këtë ndërprerje të ujit të pijshëm në mënyrë që të merrnim masat konkrete por askush nuk e ka bërë, duke na sjellë në këtë situatë", u shpreh Uruçi. Ngjarja është duke u hetuar nga organet hetimore, ndërkohë Bashkia e Shkodrës ka deklaruar se Spitali i këtyj qyteti do të furnizohet me ujë ditën e nesërme pavarësisht mungesës së ujit në pjesë të tjera ta qytetit.

**SADI VORPISI:**

**Mbledh grupin e punës pas ankesave për tregjet**

Ankesat e qytetarëve për cilësinë e tregjeve dhe për mënyrën e administrimit të tyre kanë mbledhur në një takim ditën e djeshme prefektin e Tiranës Sadi Vorpsi dhe Grupin e Punës për Administrimin dhe Konformitetin e Tregjeve. Në takim kanë marrë pjesë edhe krerët e AKU, DSHP, Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit dhe nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Enno Bozdo.

Prefekti ka kërkuar që kontrollin në tregje të jenë më të shpeshta në shërbim të rritjes së cilësisë në këto tregje dhe shëndetit të qytetarëve. "Vëmë re se aktivitetet ushqimore ushtrojnë veprimtarinë e tyre jo vetëm në kushte informale, por edhe në shkelje të vazhdueshme të ligjeve. Aktivitetet të cilat nuk zbatojnë detyrimet ligjore dhe standartet higjieno-shëndetësore do të gjobiten", u shpreh Vorpsi.

## » KONTRABANDA

# Vendimi, 3 mln lek gjobë mikut të Arben Imamit

Kushëri i ish-ministrit të Mbrojtjes u shpall fajtor për kontrabandimin e ilaçeve

**ELTON QYNO**  
TIRANE

**D**ënohet me 3 milion lekë të vjetra Bardhyl Imami, kushëri i ish-ministrit të Mbrojtjes Arben Imami. Vendimi është dhënë nga gjyqtarja Klorinda Çela në datën 8 maj, e cila ka deklaruar fajtor të pandehurin Bardhyl Imami, duke e dënuar atë me gjobë financiare. Vetë prokurori Etien Kapo, në pretencën e tij ka kërkuar dënimin e Imamit, me 4 milion lekë burg, ndërkohë që gjyqtarja Çela ka vendosur ta dënojë me 4.5 milion lekë gjobë, por për shkak të aplikimit të nenit 406 të K.P. Penale, i pandehuri ka fituar 1/3 e uljes së dëmit, duke u dënuar përfundimisht me 3




milion lekë të vjetra.

### NGJARJA

Më datë 24.01.2014, rreth orës 10:00, nga shërbimet e Policisë së Shtetit, me qëllim evidentimin e personave që tregëtojnë medikamente mjekësore në meynyrë të kundraligjshme, është konstatuar se i pandehuri Bard-

hyl Imami, duke tregëtuar medikamente mjekësore në farmaci "Shehu", që ndodhet në Rr. "Medar Shtylla". Këto medikamente janë sekuestruar nga ana e Policisë Gjyqësore. Shtetasi Ridvan Shehu, është me banim në qytetin e Tiranës dhe ushtron aktivitet në fushën e farmaceutikës, duke disponuar farmaci "Shehu", që ndodhet në Rr. "Medar Shtylla" Tiranë. I pandehuri Bardhyl Imami, ka mundur të sigurojë, në mënyrë të kundraligjshme, ndër të tjera dhe dy pako me fisha diabetikësh. Këto dy pako, me datë 24.01.2014, i pandehuri Bardhyl Imami i ka tregëtuar tek shtetasi Ridvan Shehu. Pikërisht në këtë moment, është realizuar dhe kapja në flagrancë të pandehurit Bardhyl Imami. Më pas, ndodhur në kushtet e flagrancës, është ushtruar kontrolli në banesën e të pandehurit Bardhyl Imami.

**SKEMA** e kontrabandës së ilaçeve dhe shitja e tyre në farmacinë "Shehu" në kryeqytet



Faksimile e vendimit të Gjykatës së Tiranës që dënon me 3 milionë lekë gjobë Bardhyl Imami

Gjatë kontrollit të ushtruar janë gjendur e sekuestruar 274 pako me medikamente të ndryshme, të cilat nuk dispononin pullën fiskale. Gjithashtu, nga ana e të pandehurit Bardhyl Imami nuk disponohej asnjë lloj dokumentacioni mbi këto medikamente. Njëkohësisht, gjatë kontrollit në banesën e të pandehurit Bardhyl Imami, janë gjendur e sekuestruar dhe dy blloqe shënimesh. Në këto dy blloqe pasqyrohen disa shit-blerje të ndryshme të kryera nga ana e të pandehurit Bardhyl Imami të medikamenteve tek perso-

na të ndryshëm. I pyetur gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit i pandehuri e ka pranuar akuzën, për kryerjen e veprës penale "Tregtimi dhe transportimi të mallrave që janë kontrabandë". Gjykata, pasi ka administruar në tërësi fashikullin e prokurorisë, me Nr. 699 procedimi, viti 2014, e cila më pas u bë pjesë e fashikullit të gjykimit, konkludon se i pandehuri Bardhyl Imami ka konsumuar elementët e veprës penale të "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

## LAJME shkurt

### Kapet Agushi i gjenden armë e antiplumb

— Policia e Tiranës ka vënë në pranga një 36-vjeçar për amrbajtje pa leje si dhe ka sekuestruar 2 automatik, një sasi të konsiderueshme fishekësh dhe disa jelekë me mbishkrimin policia. Operacioni është zhvilluar në rrugën Bardhyl në kryeqytet, ndërsa forcat e komisaritit nr. 4 kanë mundur të arrestojnë Dritan Agushin. Gjatë kontrollit të ushtruar në pronën e Agushit, një magazinë policia ka sekuestruar armë si dhe një automjet tip Volvo. Aktualisht është bashku me Dritan Agushin është proceduar dhe babai i tij 57 vjeçari Agush Agushi.



Ilir Dhimo

### U kapën me 96 kg C4, burg ushtarakëve

— Gjykata e Tiranës ka dhënë masën e sigurisë për 4 ushtarakë e akuzuar se kanë vjedhur 96 kg C4 nga depot ushtarake me qëllim që ta shisnin. Gjykata ka vendosur dje masën e sigurisë burg pa afat për Pëllumb Dacin, Emild Takun, Ilir Dhimo dhe Artur Çelon, masa e arrestit u janë komunikuar gjatë ditës. Emild Taku, ka qenë efektiv i Batalionit të Transportit në repartin pranë Urës së Beshirit. Ilir Dhimo, ka ushtruar funksionin e kapitenit në sektorin e e asgjësimit të municioneve të Ushtrisë, Artur Çelo ka qenë kapter ndërsa Pëllumb Daci, major.

### KËRKIME PËR NAUM GUSHON

## Pogradec, zhduket prej 5 ditësh babai i 3 vajzave

— Një 63-vjeçar, me profesion elektrikist, është zhdukur në mënyrë misterioze në Pogradec. Bëhet fjalë për shtetasin Naum Gusho, 63 vjeç, babai i tre vajzave. Sipas policisë, Gusho ka dalë nga shtëpia në orën 10:00 të së hënës së 19 majit për të shkuar në punë pasi ishte elektrikist në qytetin liqenor por nuk është kthyer më në banesë. Të njëjtat burime njoftojnë se 63-vjeçari nuk ka pasur konflikte me njeri, ndërsa edhe familjarët konfirmojnë se ai nuk vuante nga ndonjë sëmundje. Denoncimi në polici është bërë nga familjarët, pasi e kanë parë që kryefamiljari nuk po kthehej. Njëkohësisht ata kanë bërë kërkime dhe kontrollë edhe tek të afërmit e tyre por nuk kanë gjetur asnjë gjurmë. Gjithashtu të afërmit e kanë kërkuar edhe në



Naum Gusho

vendin e punës, por edhe ata nuk kanë dhënë ndonjë informacion për të. Pas këtyre i janë drejtuar policisë dhe kanë bërë denoncimin. Këta të fundit kanë marrë disa dëshmi të personave të afert të tij, por nuk kanë mundur që të marrin informacione të vlefshme. Për këtë qëllim janë njoftuar edhe policitë e qarqeve fqinje dhe më gjerë. Sipas policisë vijojnë kërkimet për gjetjen e tij, por ende nuk ka asnjë gjurmë të Gushos.

# Vrasja e Lamajt, dëshmia: Pashë makinën e Frrokut

Dëshmojnë, Arlind Aliaj dhe Armando Myftari



Arben Frroku



Dritan Lamaj

**D**y persona kanë dhënë dëshmitë e tyre për momentin e vrasjes së Komisarit Dritan Lamaj, krim për të cilin është vënë në pranga Arben Frroku. Ditën e djeshme në Gjykatën e Krimeve të Rënda është zhvilluar edhe seanca e radhës së gjyqit ndaj Frrokut. Gjatë seancës janë pyetur dëshmitarët Arlind Aliaj, i cili punonte si kamarier te një lokali pranë vendit ku ndodhi vrasja dhe Armando Myftari. Në dëshminë e tij Aliaj shprehet se kishte parë Lamaj dhe një djalë që ishte në lokal, kishte dalë dhe e kishte ndihmuar, ai shton se më pas e çuan me një makinë


të rastit në spital. "E mbaj mend vrasjen e Lamajt, isha në lokal. Kur ndodhi ngjarja ishte ora rreth 18:30"-ka thënë në seancën e gjyqit dëshmitari Arlind Aliaj. Sipas dëshmisë së tij, Dritani po vinte drejt lokalit në momentin kur u qëllua, ku shumë persona dolën nga lokali dhe i dhënë ndihmën", ka thënë kamarieri. Sipas tij, lokali nuk kamera dhe nuk ka pasur pamjet. Ndërkaq, dëshmitari Arlind Aliaj është

sjellë nga policia në seancën e djeshme me urdhër të trupës gjyqësore. Dëshmitari tjetër Armando Myftari i cili ka qenë klient në një lokal pranë vendit të ngjarjes, ka thënë në sallën e gjyqit se e ka parë makinën e Frrokut, por pas kismave nuk i ka parë autorët. "Pashë një makinë gri dhe xhamat që u thyen, pas të shtënave, pashë të shtrirë Dritanin. E morëm dhe e dërguam në spital", ka thënë ai.

### Xhaxha e nip plagosin me thikë të riun

— Një plagosje me thikë dhe sende të forta ka ndodhur dy ditë më parë në Përmet, pas një konflikti mes dy të rinjsh, ndërkohë dje policia ka bërë të mundur arrestimin e një prej personave të dyshuar në krim. Mësohet se i plagosur ka mbetur Edmond Mamushi, i cili është transportuar me helikopter drejt Tiranës, ndërsa në pranga të policisë ka rënë Artan Hoxha, 50 vjeç. Sipas policisë xhaxha e nip kanë plagosur për motive të dobëta Mamushin, ndërsa policia ka shpallur në kërkim nipin e 50-vjeçarit, J.Hoxha.

# » » DOKUMENTI EKSKLUZIV



Faksimile e procesverbalit të mbledhjes së Sekretarëve të Komitetit Qendror 14 dhjetor 1983



## ENVER HOXHA - SIMON STEFANI “Rebelime te forcat xhenjo, kanë sulmuar depot e armëve”

Procesverballi i 14 dhjetorit 1983/ Pse dërgoheshin tek forcat xhenjo të rinjtë me biografi të keqe dhe ish-të burgosurit? Pse nuk pajiseshin ata me armë në radhët e ushtrisë. Dialogët në mbledhjen e sekretarëve të Komitetit Qendror...

**ADMIRINA PEÇI**  
TIRANË

**A**ta djem të rinj që kishin njolla në biografi, apo që dikur ishin dënuar në burgjet komuniste në radhët e ushtrisë. Pas rekrutimit, atyre nuk u jepej armë, sikurse ndodhte me çdo ushtar tjetër. Të gjithë këta rinj dërgoheshin në repartet e forcave xhenjo dhe nga oficerët shiheshin gjithnjë me dyshim. Ish-ministri i mbrojtjes Simon Stefani i raporton Enver Hoxhës në mbledhjen e sekretarëve më 14 dhjetor 1983 në këta elementë ishin kthyer në shqetësim në radhët e ushtrisë. Ndërsa tregon se cilët sektorë në ushtri punonin mirë, Hoxha e ndërpret dhe i thotë: “Nuk pyes kush shkon mirë, po dua të di ku shkojnë më dobët punët? Këtë dua unë të më sqarosh”. Pas kësaj ish-ministri i mbrojtjes Simon Stefani flet për problemet që ka me divizionet e veriut, sidomos atë të

Pukës e të Shkodrës, ku në repartet e xhenjos ishin shënuar edhe më shumë shkeljet e disiplinës dhe të rregullave, duke e justifikuar këtë me rebelimin e djemve të rinj të rekrutuar në ushtri nga familje me qëndrim jo të mirë politik apo në radhët e ish të burgosurve.

“Në këtë njësi ka thyerje të disiplinës nga ana e ushtarëve, po qëndrime jo korrekte ka edhe nga ana e oficerëve ndaj ushtarëve. Atje ka edhe largime të ushtarëve nga repartet”, thotë Simon Stefani, ndërsa shpjegon se edhe disa oficerë kanë mbajtur qëndrime jo korrekte, pasi ushtarët që thejnë disiplinën i qëllojnë edhe me pellëmbë.

“Kur ushtarët shkelin disiplinën, kur shkelin rregulloret, apo kur largohen pa leje nga reparti, oficerët nuk përdorin si dhe sa duhet metodën e bindjes në bazë të rregulloreve, bile ka pasur raste që është përdorur edhe forca kundër ndonjë ushtari”, e sqaron Simon Stefani udhëheqësin Enver Hoxha.

Sipas tij, në këto reparte edhe disiplina është më e dobët, madje në di-

vizionin e Pukës dhe në atë të Shkodrës sipas tij, në atë vit (1983) ka pasur edhe tentativa për të hapur depot e armëve. Simon Stefani saktëson se në Pukë “na janë vjedhur nja dy armë, kurse në Shkodër para ca ditësh na janë vjedhur ca kapsolle për ndezjen e dinamitit”.

Edhe pse duket alarm i çuditshëm, dhe gati i palogjikshëm për ta cilësuar këtë argument si orvatje për të hapur depot e armëve, për udhëheqësit komunist duket se perceptimi është tjetër. Ata diskutojnë pas kësaj me seriozitet, duke analizuar se mund të ndodhin vjedhje të armëve dhe lëndëve plasëse në një kohë kur çdo objekt ruhej me roja që paguheshin nga shteti.

Ish-ministri i mbrojtjes, sqaron Hoxhën dhe Ramiz Alinë se në rastet e vjedhjeve hajdutët kishin hyrë nga dritaret e depove dhe se kapsollat dhe dinamitin i vidhnin për të vrarë peshq në lumë e liqen. Dokumentin e plotë mbi këtë çështje e sjellim më poshtë së bashku me faksimilet e procesverbalit të dalë nga kjo mbledhje e sekretarëve të komitetit qendror në dhjetor 1983.



### Shqetësimi i udhëheqjes në '83-shin

# “NË SHQIPËRI, 12 MIJË ROJEME PAGESË, SI MUND TË NDODHIN VJEDHJET?”

## Dokumenti

**Shoku Enver Hoxha:** Në ushtri ka ndonjë gjëkafshë! Si është gjendja?

**Shoku Simon Stefani:** Jo, shoku Enver, nuk ka ndonjë gjë për të shënuar. Tani sa u bë mobilizim-çmobilizimi dhe po përgatitemi për fillimin e vitit të ri mësimor, po më parë janë duke u bërë analizat vjetore. Nesër dhe pasnesër këto do t'i kemi në ministri. Në përgjithësi, mirë është gjendja. Këtë vit janë marrë masa të mira edhe për qendrat e instruksionit të ushtarëve të rinj, se vjet patëm disa vështirësi, kurse sivjet çdo divizion ka marrë masat e nevojshme, qoftë për mbarëvajtjen e stërvitjes, qoftë për strehimin dhe zgjidhjen e gjithë problemeve të tjera. Punimet fortifikuese mbrojtëse, në përgjithësi mirë po shkojnë, po punohej në përfundim janë ato. Siç ju tha shoku Prokop, planin operativ ne do ta shikojmë pasnesër, kurse nga data 26-27 dhjetor do ta shohim me shtabin e përgjithshëm. Teksti gati është përfunduar, kurse në tremujorin e parë e kemi për ta parë në këshillin e mbrojtjes.

**Shoku Enver Hoxha:** Po puna politike në ushtri si shkon?

**Shoku Simon Stefani:** Në përgjithësi, mirë, shoku Enver.

**Shoku Enver Hoxha:** Si punojnë komisarët? Po organizatat bazë të Partisë reagojnë, veprojnë, janë në rregull? Ka gjëkafshë ndonjë dukje negative?

**Shoku Simon Stefani:** Në përgjithësi, këtë vit kujdesi i organizatave bazë të Partisë, shoku Enver, dhe i tërë punës politike që bëhet në ushtri është përqendruar kryesisht për të sqaruar e mbështetur deri në fund ato detyra që shtroi Byroja Politike për riorganizimin.

**Shoku Enver Hoxha:** Po gjendja kudo njësoj është?

**Shoku Simon Stefani:** Jo, nuk është njësoj kudo, ka ndryshime midis njësjëve e reparteve.

**Shoku Enver Hoxha:** Po ku ka dobësi, në ç'divizion, në përgjithësi në ç'repartë?

**Shoku Simon Stefani:** Divizioni i Pukës për shembull, shkon mirë shoku Enver.

**Shoku Enver Hoxha:** Nuk pyes kush shkon mirë, po dua të di ku shkojnë më dobët punët? Këtë dua unë të më sqarosh.

**Shoku Simon Stefani:** Më dobët kemi divizionet e xhenios, shoku Enver.

**Shoku Enver Hoxha:** Divizioni i Xhenios, pse?

**Shoku Simon Stefani:** Në këtë njësi ka thyerje të disiplinës nga ana e ushtarëve, po qëndrime jo korrekte ka edhe nga ana e oficerëve ndaj ushtarëve. Atje ka edhe largime të ushtarëve nga repartet.

**Shoku Enver Hoxha:** Të ç'natyre janë qëndrimet jo korrekte të oficerëve ndaj ushtarëve?

**Shoku Simon Stefani:** Kur ushtarët shkelin disiplinën, kur shkelin rregulloret, apo kur largohen pa leje nga repartit, oficerët nuk përdorin si dhe sa duhet metodën e bindjes në bazë të rregullorevë, madje ka pasur raste që është përdorur edhe forca kundër ndonjë ushtari.

**Shoku Enver Hoxha:** Domethënë përdoret forca? Po çfarë force, në ç'formë përdoret kjo?

**Shoku Simon Stefani:** Ka pasur raste kur ndonjë oficer ka goditur ushtarin, duke e qëlluar me pëllëmbë.

**Shoku Enver Hoxha:** Ky mund të jetë ndonjë rast i veçantë besoj, jo si fenomen i përgjithshëm.

**Shoku Simon Stefani:** Jo nuk them se është fenomen i përgjithshëm, këto kanë qenë raste të shpëputura. Në divizionin e xhenios kemi një çikë edhe largimet e ushtarëve më tepër nga shërbimi, nga detyra. Këto shkelje janë më të theksuara në disa repartë të zonave të veriut, si për shembull në divizionin e Shkodrës.

**Shoku Enver Hoxha:** Po pse ngjet kjo? I kanë bërë analizat në këto njësi përse ngjasin këto shfaqje?

**Shoku Simon Stefani:** Po, i kanë bërë. Kam thirrur unë si komisarim e divizionit ushtari edhe shokët kryesore të komitetit të Partisë të këtij divizioni.

**Shoku Enver Hoxha:** Po ç'konkluzione kanë dalë nga këto biseda që keni bërë? Pse ndodhin këto shkelje?

**Shoku Simon Stefani:** Konkluzioni është ky, shoku Enver, në divizionet e xhenios, përveç ushtarëve që rekrutohen si gjithë të tjerët, dërgohen elementë nga më të padisiplinuarit.

**Shoku Enver Hoxha:** Po sa mund të jenë këta?

**Shoku Simon Stefani:** Nuk janë pak. Si numër ekzakt nuk i di, po në këto reparte shumë janë, se dërgohen në të gjithë ata djem që kanë qenë të dënuar. Të gjithë ata që dalin nga burgju, në repartet e xhenios dërgohen.

**Shoku Enver Hoxha:** Po sa janë, xhanëm, si numër, se mendoj që nuk janë aq shumë ata që dalin nga burgju.

**Shoku Ramiz Alia:** More po ata janë djem 18-vjeçarë këta, prandaj çfarë burgju kanë bërë?

**Shoku Simon Stefani:** Është fjala për burgosje gjatë jetës civile. Pastaj edhe djemtë e familjeve me qëndrim të keq politik në këto reparte i çojmë dhe

nuk i armatosim, këtyre nuk u japim armë. Dhe pikërisht në këto është më e dobët disiplina. Në divizionin e Pukës dhe në atë të Shkodrës këtë vit ka pasur orvatje për të hapur depot, bile në Pukë na janë vjedhur nja dy armë, kurse në Shkodër para ca ditësh na janë vjedhur ca kapsolla për ndezjen e dinamitit. Pra nga veriu ka prirje për të vjedhur armë, dinamit, kapsolla e të tilla objekte plasëse. Në nja dy reparte të divizionit të Shkodrës dhe të atij të Tiranës, si dhe në Pukë na kanë ndodhur të tilla ngjarje. Ndonjë fakt deri tani nuk kemi gjetur, nuk i kemi zbuluar dot akoma fajtorët. Por veç të tjerave vërtetohet se ka pakujdesi edhe në vendosjen e shërbimit të rojës.

**Shoku Enver Hoxha:** Përse u duhen këto kapsulla? Përse u shërbejnë atyre që i vjedhin?

**Shoku Hekuran Isai:** Për të zënë peshk?

**Shoku Simon Stefani:** Ata përdoren edhe për peshk, se i vë llokumen e dinamitit ai, ky shpërthen dhe këshutu vrasin peshkun nëpër menjë e liqene. Po të tilla mjete mund t'i përdorin edhe për qëllime të këqija, siç janë të dy rastet në Shkodër që e përdorin kundër shefit të policisë një personi tjetër.

**Shoku Enver Hoxha:** Po dinamit vjedhin?

**Shoku Simon Stefani:** Po, edhe vjedhin.

**Shoku Enver Hoxha:** Ku i vjedhin?

**Shoku Simon Stefani:** Nëpër vendet ku bëhen punime mbrojtëse, fortifikuese nga ushtria. Vjedhin nga këto edhe në terren, si nëpër miniera, në karrierat e hapjes së gurëve, etj.

**Shoku Enver Hoxha:** Po ç'lidhje kanë ushtarët me minierat e gurit?

**Shoku Simon Stefani:** Unë u përgjigja pyetjes që më bëtë ju se nga e vjedhin këta njerëz dinamitin dhe ju tregova cilat janë burimet nga të cilat mund t'i marrin vjedhësit. Këto ne nuk i kemi kapur, se nuk i kanë vjedhur ushtarët, po njerëz të tjerë.

**Shoku Enver Hoxha:** Si njerëz të tjerë, kush janë këta?

**Shoku Simon Stefani:** Njerëz të tjerë nga jashtë që nuk janë zbuluar akoma.

**Shoku Ramiz Alia:** Po mirë është gjetur hapur depoja e kapsullave?

**Shoku Simon Stefani:** Posi, vjedhësit ose kanë hapur depone, ose janë futur nga penxherja.

**Shoku Ramiz Alia:** Po nuk ka roje në depot e armëve dhe të gjitha këtyre mjeteve plasëse?

**Shoku Enver Hoxha:** Ka, si nuk ka?

**Shoku Ramiz Alia:** Po atëherë si janë futur?

**Shoku Enver Hoxha:** Ka rreth 5600 veta a nuk e di me saktësi se sa janë gjithsej rojet në numër.

**Shoku Hekuran Isai:** Në tërë Shqipërinë ka 12 mijë roje, ushtarë dhe civilë, që janë me rrogë.



**Koment**

# Martin Schulz: "E kuqja, jeta ime"



vijon nga faqja 1

...pranë e keni një të tillë", tha Schulz plot vetëdije në një debat televiziv në televizionin publik gjerman ZDF.

**TË RIFITOHET BESIMI**

Ai e sheh veten si avokat të njerëzve të thjeshtë, të cilët po zhgënjehen prej kompleksitetit të BE-së. "Një ndër elementët kryesorë të kritikës, që has unë në Europë, kudo që jam, është, se njerëzit më thonë: Epo, BE-ja ekziston dhe ajo vepron e influencën në jetën tonë të përditshme, por zëri ynë nuk përfilllet aspak." Këtë do ta ndryshojë Martin Schulz dhe ai kandidon për postin e presidentit të Komisionit, pra të shefit të administratës europiane në Bruksel.

Këtu ai do të luftojë për vende pune, drejtësi fiskale dhe për këthim të kompetencave nga Brukseli tek vendet anëtare. "Çfarë mund të bëjmë ne më mirë në nivelin lokal apo rajonal? T'u kthesh njerëzve politikën dhe përgjegjësinë, padyshim që do të thotë të rifitosh besimin e tyre", thotë në intervistë për DW politikani socialdemokrat. Roli i tij si avokat i qytetarëve të thjeshtë nuk e ka penguar Schulz-in, që krahas pagës si president i Parlamentit Europian të marrë edhe paga të majme suplementare. Vetëm pasi u kritikua me hapjen e fushatës elektorale ai udhëzoi t'i ndërpriten këto pagesa.

**SCHULZ SHPESH LEXON TRE LIBRA PARALELISHT**

Mënyra e tij e shpenguar e shprehjes nuk mirëpritet prej kujtdo. Kryeministrat ndon-

jëherë preferojnë ta quajnë atë si "mendjemadh". Schulz gjuhëshpatë ua hedh poshtë kritikën kundërshtarëve të vet. Ndonjëherë bashkëpunëtorëve të tij gëzueshëm ai u thotë: "Jeni të pushuar të gjithë nga puna!" Por kjo është vetëm një shaka, relativizon Martin Schulz, i cili pranon me vetëkritikë, se ndonjëherë tregohet mjaft i vetëdijshëm dhe do ta arrijë gjithçka shumë shpejt.

Këtë ai e ka kuptuar shumë herët, përpara tridhjetë vjetësh gjatë një terapie të sukseshme kundër vesit të alkoolit. Martin Schulz donte të bëhej në fakt futbollist profesionist. Kjo ëndërr mori fund për shkak të një dëmtimi në gju. Asokohe 24 vjeçari e gjeti ngushëllimin tek alkooli, madje ra në depresion dhe donte të bënte vetëvrasje. Vëllai i tij Ervin, mjek, e solli atë sërisht në udhë të mbarë. Martin Schulz nisi një biznes privat si tregtues librash. Ai nuk ka studiuar kurrë në universitet, por lexon me pasion të madh. Edhe sot e kësaj dite vazhdimisht ai lexon tre libra paralelisht. Schulz filloi të merret me politikën dhe bëri karrierë. Lidhur me vesin e alkoolit, që tani ai e ka kapërcyer plotësisht, sot ai flet shumë hapur.

**EUROPIAN QYSH NË DJEP**

Europa i është ushqyer qysh në djep 58 vjeçarit Martin Schulz. Farefisi dhe të afërmit e tij jetojnë brenda dhe jashtë kufirit gjerman në tri këndëshit kufitar Gjermani, Belgjikë dhe Holandë. Schulz flet rrjedhshëm frëngjishten, anglishten dhe italishten. Madje ai flet edhe dialektin e Renanisë, siç thotë me humor. Të afërmit e tij në Luftën e Parë Botërore u është dashur të luftojnë kundër njëri-tjetrit, sepse ata banonin në shtete të ndryshme. Por kjo marrëzi është kapërcyer me bashkimin europian pas Luftës së Dytë Botërore, sidoqoftë ajo duhet kujtuar edhe sot e kësaj dite. "Ne si brez i pasluftës shpesh as që e kemi të qartë se çfarë kemi trashëguar. Unë kam pasur mundësi të jetoj në liri me shans, të cilat prindërit e mi as që guxonin t'i ëndërronin. E ne nuk i japim më vlerë kësaj." Martin Schulz indinjohet, se sa i keq është imazhi i Europës tek zgjedhësit. Një fushatë



Martin Schulz

elektorale interesante duhet ta ndryshojë këtë imazh. Vendimet nuk duhet të merren më pas derye të mbyllura në Bruksel nga 28 kryetarët e shteteve dhe të qeverive, kritikon ai sa herë që i jepet rasti.

Megjithatë ai tani është bërë disi më i butë, që kurse kancelarja kristiandemokrate gjermane Angela Merkel dhe socialdemokratët bashkëqeverisin në Berlin. Ai e di se nëse do të arrijë postin kryesor europian, ka nevojë për dashamirësinë e kryetares së qeverisë së vendit më të madh anëtar. Ai madje është edhe disi kërenar që ka numrin e celularit të Merkelit. Të pshutetshme në Bruksel, që rrudhin fytyrën duke konsideruar se Schulz nuk është i përshtatshëm si president i Komisionit, pasi ai asnjëherë nuk ka drejtuar ndonjë qeveri në nivel kombëtar, ai u kundërvihet me fjalët: "Unë kam qenë kryetar bashkie në një qytet të vogël, por atje i kam përjetuar çdo ditë shqetësimet e njerëzve për shkollën e fëmijëve të tyre, për vendin e tyre të punës apo për përkujdesin ndaj prindërve të tyre. Unë besoj, se ajo që presin njerëzit sot nga Brukseli është, që në krye të Komisionit të jetë dikush, i cili i njeht mirë dhe i vlerëson me seriozitet problemet e jetës së tyre të përditshme."

**TË MBETESH NJERI**

Kur Martin Schulz me ekipin e vet elektorale është duke udhëtuar me avion apo me makinë

herë pas here ai merr në krah një kafshë të vogël plastike. "Ky është një hipopotam, që kam për shans. Ma ka dhuruar vajza ime, kur ishte gjashtë vjeç. Ai më sjell fat." Dy fëmijët e tij dhe gruaja janë shumë të rëndësishëm për të. Kur gruaja e lavdëron atë me mesazh SMS, kjo është për Martin Schulz më me vlerë se sa një SMS nga kancelarja, prej së cilës si president i Parlamentit ai herë pas here merr mesazhe.

Pavarësisht fushatës së lodhshme elektorale gjatë muajve të fundit Martin Schulz shumë zgjedhës nuk i njeh. Jashtë hapësirës së Brukselit atë thuajse nuk e njohin, por sidoqoftë ai është më i njohur se rivali i tij konservator, Jean-Claude Juncker, ish-kryeministri i Luksemburgut. Një impuls popullariteti i dhe atij para shtatë vjetësh kryeministri italian në Parlamentin Europian me një krahasim të padëgjuar ndonjëherë: "Zoti Schulz, në Itali ndërkohë po xhirohet një film mbi kampet nacionalsocialiste të përqendrimit. Unë do të propozoj që ju të luani rolin e kapos, të drejtuesit të kampit", ironizonte në 2007 Silvio Berlusconi. Ky skandal e nxori Schulz-in në kryetrikujt e medias. Ndërkohë ai i është disi mirënjohës Berlusconi-t për këtë reklamë të paqëllimtë, por ai asnjëherë nuk është pajtuar me Berlusconi-n. "Unë mund të jem kokëfortë", thotë Schulz për veten e vet. (marrë nga Deutsche Welle)

## [SHQIPTARJA.com]

**NE VERSIONIN DIXHITAL**

**KURSENI!**

**DUKE BLERË ABONIMIN, JU MUND TË LEXONI GAZETËN QË NGA ORA 2:00 E MËNGJESIT, DHE PAGUANI MË PAK**

**Lexojeni gazetën në**

iphone

ipad

në kompjuter

Në adresën: www.shqiptarja.com

SHKARKON FALAS APP  
TEK: www.SHQIPTARJA.COM NGA APPLE STORE

## » EKSPOZITA

**ANDON ZAKO ÇAJUPI** e shkroi poezinë në shkurt të vitit 1913, para ardhjes së Vidit. Poeti i uron mirëseardhjen që nga Misiri i Egjiptit

# Zbulohet poezia e panjohur e Çajupit për Princ Vidin


Përfaqëson shpresat se me ardhjen e Vidit do të shpëtohej Shqipëria nga copëtimi

**DHURATA HAMZAI**  
TIRANE

Kujtimi i Princ Vidit është rikthyer dje në Bibliotekën Kombëtare përmes një ekspozite të hapur për publikun. Nën titullin "Vil-hemi I", ekspozita nis me një dhuratë të Vidit dhe bashkëshortes së tij Sofia për mësuësin e tyre të gjuhës shqipe Kolë Kraja në vitin 1913. Në këtë album të rrallë shihen firmat origjinale të Vidit dhe bashkëshortes Sofia dhe prapjekjet e tyre të para për të shkruar

gjuhën shqipe. Princ Vidi erdhi në Shqipëri më 7 Mars të vitit 1914, por në ekspozitë gjendeshin dokumente ku ardhja e tij ishte paralajmëruar më herët nga shtypi i kohës me një retorikë të ekzaltuar dhe euforike. Autorët e shkrimeve e shohin ardhjen tij si shpëtim të kombit. Biblioteka Kombëtare ka ekspozuar ndër të tjera disa shkrime me biografikë e Vidit në gjuhën shqipe me emrin e autores Carmen Sylva, pseudonim i Mbretëreshës së Rumanisë, Elizabeta, që ishte halla e Vidit. Të gjitha dokumentet janë ekzemplare që publikohen për herë të parë, por ajo që

të bënë përshlyetje është një poezi jo shumë e njohur për publikun e sotëm e Andon Zako Çajupit, e shkruar para ardhjes së Vidit, në shkurt të vitit 1913. Poeti i uron mirëseardhjen që nga Misiri i Egjiptit. Në poemën Çajupit me titull "Mbretit të Shqipërisë", hidhet dritë mbi qëndrimin e intelektualëve bashkëkohës të tij; ardhjen e Princ Vidit e konsideronin si afirmim dhe ruajtje të sovranitetit të kërcënuar të Shqipërisë nga fqinjët shovinistë. Ndaj, në vargjet e poezisë së Çajupit të bie në sy bindja se ardhja e Vidit është interesi i kombit dhe i Atdheut. Ja poezia:



(Lar) Ardhja e Princ Vidit në Durrës. (Poste) Faksimile e dokumenteve të ekspozuara në Bibliotekën Kombëtare

### Mbretit të Shqipërisë

Kush do foli mbë vend mbeti...  
Na shpëtoi Perëndia Erdhi Mbreti!  
Erdhi Mbreti! Gëzon gjithë Shqipëria.  
Erdhi mbreti i Shqipërisë  
Dhe zu vënd' e Skënderbeut!  
U-ngre flamur' i Lirisë  
Sot nga burrat e Atdheut.  
Me këtë flamur ndë duar.  
Me këtë mbret fuqplotë  
Shqiptarët të bashkuar  
Do të dëgjonin në botë.  
Lum neve për këtë ditë!  
Dielli ndrizon Tomorrë...  
Errësira, ligësitë, Bashkë me  
turkun u-cporrë.  
Ra dielli në vend tonë...  
Shqipëria lulezoi!  
O shokë lëvdoni Zonë  
Për mbretinë që na dërgoi.  
Shqiptarët citë janë  
Që të falë mbretërinë?  
Këta jan' ata Luane  
Që kanë trembur Turqinë.  
Këta trima Zot, të prunë  
Dhe të besuan Atdhenë,  
Me kurorën që të vunë  
Të njëjtën për Skënderbenë  
Zot, ndë fron të mbretërisë  
Të kesh dëshirë që të kemi  
Për lirin' e Shqipërisë  
Të lëftojmë gjithë ç'jemi  
Zot, kufij' e Shqipërisë  
Nuk janë tek u shtruan  
Na shkel' armiq' e Lirisë  
Dhe shumë vise zotuan:  
Në meleun shqiptarë  
Sot ndën zjedhë rënkojmë  
Dhe na presin duke qarë  
Të vemi që të shpëtojmë

## GRACE OF MONACO

15 Maj

**Titulli:** Grace of Monaco  
**Regjia:** Olivier Dahan  
**Skenari:** Arash Amel  
**Aktorë:** Nicole Kidman, Tim Roth, André Penvern  
**Kohëzgjatja:** 103 minuta  
**Gjinia:** Biografi, Dramë

**Sinopsi:** Historia e ish-aktores së Hollivudit, Grace Kelly, kriza e saj e martesë dhe identitetit, gjatë një debate politik mes Princit të Monakos, Rainier III presidentit francez Charles De Gaulle.

Rr: Murat Toptani  
Tel: 04 22 53 654 / 22 53 655  
www.kinemamillennium.com email: info@kinemamillennium.com  
facebook.com/kinema.millennium.tirana

 SATIRË POLITIKE

NGA ARBEN DUKA



# Aksioni antikombëtar i opozitës..

(Pjesa e Dytë)

Që sot ka protestë,  
ishim lajmëruar,  
po një grevë urie,  
s'e kishim menduar!

Qe si vetëtimë,  
në qiell pa re,  
ndaj kemi përpara,  
situatë të re..

Kundër asaj çadre,  
unë nuk hedh dot gurë,  
me një grevë urie,  
s'mund të tallem kurrë!

Greva e urisë,  
është veprim ekstrem,  
ndaj kundër grevistëve,  
nuk kam se ç'të them!

Nuk kam se ç'të them,  
kur dikush ngujohet,  
por i bie vlera,  
kur politizohet!

S'i them opozitës,  
që ta mbylli gojën,  
por me tinëzi,  
po e bën gjithë "lojën".

Në prag të Qershorit,  
kur ne presim ftesën,  
Sala në protesta,  
po nxjerr edhe mbesën!

Po pse e nxjerr mbesën,  
në protestë-o gjysh?!  
Që parajsa jote,  
të kthehet sërish!

Kuptohet-gjithë punën,  
ajo s'na e prishi,  
po ftesë e BE-së,  
nuk vlen- sa vlen gjyshi!

Nuk vlen-sa vlen gjyshi,  
gati shekullor,  
që frenat sërish,  
po i merr në dorë!

Po e merr në dorë,  
grevën dhe hashashin,  
dhe sërish në bisht,  
po e lë Lulashin!

Se Sala u bë,  
bishë me të vërtetë,  
kur Luli nuk mblodhi,  
dot as njëmijë vetë!

Ndaj të gjithë dëgjuam,  
kur pamë estradën,  
thirrjet si në kor,  
"Duam Sali Babën!"

Në një kor të vetëm,  
dëgjuam miletin,  
që thoshin e thoshin  
"Neve duam mbretin!"

Dhe mëndjen kaq shumë,  
s'ka pse vret njeriu,  
kuptohet që mbreti,  
është xhaxha Saliu!

Duket Luli i vockël,  
nuk u'a mbush hiç synë,  
ndaj kërkojnë mbretin,  
domethënë Salinë!

Kuptohet-thërrisinin,  
lolot e oborrit,  
që duan t'u kthehet,  
koha e doktorit!

Ndaj them se aksioni,  
do jetë krejt i kotë,  
se tani problemet,  
zgjidhen veç me votë!

Këtë e di Sala,  
se s'është budalla,  
po tash që po flasim,  
vota fare s'ka!

Ndaj s'janë për pushtet,  
protestat e reja,  
po thjesht të mos marrim,  
ftesën nga BE-ja!

## Të mbajmë gjallë të vërtetën!..

(Vargje të botuara në kohën e pushtetit të Berishës)

### HA TË HAMË...

Kapardisur e serbes,  
gjithë me lugë në brez,  
ha e ha në atë thes,  
nga mëngjesi në mëngjes.

Ha të hamë-more kasap,  
se kjo ditë nuk vjen prapë,  
ndaj dhe mos u mendo gjatë,  
vetëm ha-o malukat!

Ti nuk ha thjesht ca patate,  
po përtyp me mijëra fate,  
mijëra fate njerëzore,  
malësore dhe jugore.

Kush mund ta pengojë ariun,  
kur ha jugun dhe verium,  
ai ha-e s'bën shakara,  
dhe një mal t'i vësh përpara.

Iku kohë e bishtit të qenit,  
po ndrit koha e legenit,  
ha të hamë me qeverinë,  
mbi këtë popull bëj kërdinë.

Ha të hamë-o kapedan,  
ti Ilir e ti Tritan,  
për të ngrënë jini të thekur,  
sepse kini për të vdekur!

Ha-mor ha se të kam xhan,  
ti Topall e ti Nishan,  
hani-bëni kijametin,  
për të ngrënë vodhët pushtetin!

Ha të hamë e mos u stepni,  
gjë të tjerëve mos u jepni,  
njëmijë qëngja-njëmijë desh,  
do t'i hani me përshesh.

Ha të hamë-o zotni Ruli,  
n'ato pjesë ku bëhet tuli,  
ha dhe ti-more Lulash,  
për çdo ditë haje një dash!

Ha të hamë-o kapedan,  
Majlindw e ti Imam,  
ti Rusmal e ti Ridvan,  
gjë mos lini në kazan!

Këtë vakt e kishim pritur,  
ndaj jemi të babëzitur,  
ha të hamë- siç dini vetë,  
këtë vënd e këtë shtet.

Suluni si karkaleci,  
nuk i sos paratë Gërdeci,  
ha të hamë-o derr i derri,  
s'mbarojnë depot e Enverit!

Hani fort-o racë e hutit,  
jetojmë kohën e harbutit,  
me një frymë mbaroni butin,  
në fund kemi veç tabutin!

Ha të hamë-fare pa doza,  
pa limit si kakëzoza,  
ha tri herë vjet peshën e vet,  
dhe nga e ngrëna pëllcet!

Ha të hamë-e fryni xhepin,  
se kini Sulltan Salepin,  
hani derra-derra pini,  
gjë në këmbë të mos lini!

(Botim i vitit 2010)

(Vijon nesër Pjesa e Tretë)

## » INTERVISTA

**E REJA** e kësaj vepre që duhet theksuar është se, Sam Shepard është një dramaturgu amerikan i suksesshëm

**IZAURA NDOJ**  
TIRANE

**P**erëndim i vërtetë”, e shkruar në vitet 1980-të nga dramaturgu amerikan Sam Shepard, do të jetësohet për herë të parë në skenën shqiptare nën regjinë e Laura Nezhës. Në një intervistë për “Shqiptarja.com” regjisorja Nezha tregon arsyen se pse zgjodhi këtë dramë për ti dhënë jetë në shqip pas sukseseve që ka prekur në teatrot botërore, pasionin e saj për muzikën, si dhe projektet që ka gjatë sezonit veror. E fiksuar me të, që në momentin e parë të prezantimit me pjesën, regjisorja ngjitet në skenë kastin e aktorëve: Erblin Bajko, Ledion Zoi, Redian Mulla dhe Suela Bako në sallën e Teatrit të Komedisë këtë fundjavë, ku hyrja do të jetë e lirë. Regjisorja Laura Nezha me këtë shfaqje mbron Diplomën për regji në Universitetin e Arteve.

**“Perëndim i vërtetë”, pse keni zgjedhur pikërisht një dramë për t’iu rikthyer sërish skenës së Teatrit Kombëtar të Komedisë?**

E reja e kësaj vepre që duhet theksuar është se, Sam Shepard është një dramaturgu amerikan i suksesshëm, por e keqja e saj është se ne nuk e kemi pasur të përkthyer në shqip. Ky autor vjen për herë të parë me këtë pjesë në shqip në skenën shqiptare pas një histori suksese në disa skena botërore nën interpretimin e disa aktorëve të mëdhenjë. Drama “Perëndimi i vërtetë” është shumë aktuale dhe na sjell në mendje historitë reale që ndodhin edhe sot në Shqipëri. Një skenarist i njohur në Hollywood, me lidhjet e duhura për të krijuar famë dhe para... kundrejt një vëllai hajdut e të pamoralit i cili kthehet në shtëpi pas 5 vjetësh dhe fillon të ngatërojë jetën e Austin... Pra, në qendër të dramës është konflikti mes vëllezërve, konflikti për interesa gjë që ndodh rëndomte edhe në realitetin shqiptar.

**Shfaqja jetësohet nga katër personazhe me të cilët keni bashkëpunuar dhe më herët...?**

Aktorët Erblin Bajko, Ledion Zoi, Redian Mulla dhe Suela Bako janë aktorë që iu janë përshtatur më së miri rolet në këtë vepër dhe padiskutim që janë profesionistë në këtë fushë, duke na bërë dhe më të lehtë procesin e interpretimit në skenë.

**Veç teatrit, një pjesë e pandarë për ju është edhe muzika. Mendoni se ka ardhur momenti për një risi?**

Në fakt, kjo shfaqje vjen në kuadër të diplomës sime për regjisorë, por nuk kam dashur ta lë



Laura Nezha duke aktruar

# Laura Nezha: Ka ardhur momenti për një risi në muzikë

Artistja, mbron diplomën në Teatrin Kombëtar i Komedisë me shfaqjen “Perëndim i vërtetë”



**NË FOTO:**  
Laura Nezha

vetën në këtë kontekst por të sjell diçka që të pëlqehet dhe të jetë risi në teatër. Ndërsa përsa i përket muzikës, sapo të mbyll këtë shfaqje mendoj të vij me ndonjë projekt muzikor. Nuk është se muzikën e kam lënë pas dore, por këtë periudhë kam realizuar disa role, ku roli i fundit do të vij përmes një filmi që do të shfaqet në kinema. Malli më ka marrë shumë për të realizuar një këngë dhe besoj se së shpejti do të rikthehem muzikës.

**Si qëndron ky raport në jetën tuaj, mes teatrit dhe muzikës?**

Secila do kohën e vet, por pavarësisht kësaj lufte unë nuk heq dorë nga ansjësia, muzika dhe teatri janë pjesa ime shpirtërore e fortë. Tani që pjesën më të madhe të kohës kam qenë e fokusuar tek teatri, shpesh herë e vras mendjen për t’iu rikthyer muzikës pasi kam shumë mall për të dhe dua të punoj fortë për të sjellë një projekt muzikor të mirë, jo diçka komerciale. Nuk më pëlqen thaësira, dua një këngë që të ngelet dhe të ndjehet!

**Ju kemi parë gjithmonë të vini me balada, aty ndjeheni më mirë?**

Jo se aty gjej vetën më mirë, por nuk kam pasur



mundësi të gjej veten akoma. Unë kam luajtur role edhe në komedi dhe nuk i kam qëndruar besnik vetëm dramës, duke bërë një lloj krahasimi edhe me muzikën në këtë kontekst në të gjitha zhanret e muzikës jam e gatshme të këndo, vetëm se duhet të eksperimentoj pak me veten, ti jap mundësi vetes.

**Cilat janë projektet që do t’iu ndjekin gjatë këtij sezoni veror?**

Pas teatrit, do fokusohem tek kënga edhe pse akoma nuk e kam këngën gati dhe nuk e di nëse rikthimi në muzikë do të jetë në festival apo do dal si single me videoklip. Çdo gjë le t’ia lemë kohës, e rëndësishëm është të jetë një këngë e bukur. Ndërsa në teatër, ajo çka është e sigurt është një shfaqje në shtator në Shkup, ku kam një rol protagonistë.

## Kalendari Kulturor

### TEATRI KOMBËTAR I OPERAS DHE BALETIT

■ Recitali i këngëtarit Lek Pecnikaj dhe Ansambli Popullor “Rritet Lulja përmbi Gur” do të vij në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të dielën, 25 Maj 2014 – Ora 19.00. Programi do të përmbajë interpretime të këngëve tradicionale të veriut epiko-lirike të interpretuar nga këngëtarit Lek Pecnikaj, si dhe këngë të krijuara nga kompozitori Kol Susaj.



### PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL

#### Salla 1

- “MILLION DOLLAR ARM” 2D/ 22:30 / ÇMIMI 500 LEKE
- “X-MEN DAYS OF FUTURE” 3D/ 13:00 / ÇMIMI 500 LEKE
- “GODZILLA” 3D/ 15:30 / ÇMIMI 500 LEKE

#### Salla 2

- “SIMON” 2D/ 11:00 / 13:30 / 16:00 / 18:30 / 21:00 / ÇMIMI 500 LEKE

### KINEMA AGIMI

- “MILLION DOLLAR ARM” 2D/ 20:00 / ÇMIMI 500 LEKE
- “X-MEN DAYS OF FUTURE” 3D/ 17:30 / ÇMIMI 500 LEKE
- “GRACE OF MONACO” 2D/ 22:15 / ÇMIMI 500 LEKE
- “THE OTHER WOMAN” 2D/ 15:00 / ÇMIMI 500 LEKE
- “THE NOT JOB” 3D/ 10:00 / ÇMIMI 350 LEKE
- “GODZILLA” 3D/ 12:30 / ÇMIMI 500 LEKE

### PREMIERE BOTERORE DT. 29.05.2014

- EDGE TOMORROW 3D

### KRISTAL KINEMA

- “MILLION DOLLAR ARM” 2D/ 21:00 / ÇMIMI 500 LEKE
- “X-MEN DAYS OF FUTURE” 3D/ 12:30 / 18:45 / ÇMIMI 500 LEKE
- “THE NOT JOB” 3D/ 10:30 / 15:00 / ÇMIMI 350 LEKE
- “GODZILLA” 3D/ 16:40 / ÇMIMI 500 LEKE

**Kosova**

**DYLBER BALLA**  
PRISHTINE

Shqipëria dhe Kosova nisën pozitivisht rrugën e gjatë të bashkëpunimit në kuadër të zhvillimit të futbollit në nivel ndërkombëtar. Pas deklaratave të pas ndeshjes mes dy trajnerëve se mes dy ekipëve përfaqësues do të ketë bashkëpunim të ndër sjellte sa herë që të jetë e nevojshme ka ardhur edhe prova e parë. Mbrojtësi i kombëtares kuqezi, Mërgim Mavraj pas konsultimit me trajnerin De Biasi ka vendosur që të veshë fanellën e ekipit të Kosovës për ndeshjen me Senegalin. Mavraj, ashtu sikur edhe Debatik Curri ishin në listën e trajnerit italian De Biasi për ndeshjet miqësore që do të zhvillojë Shqipëria në kuadër të përgatitjeve për eliminatoret e kampionatit Europian 2016. Humbja e thellë e Kosovës përballë Turqisë nxori në pah shumë probleme në prapavijë për ekipin më të mirë në Europë dhe botë dukë sjellë edhe vendimin që kosovari Mavraj të pranonte që të luante për vendin e tij të lindjes. Pas vendimit, Mavraj është shprehur i lumtur që të paktën do të luajë me Kosovën. "Jam i lumtur që do të luaj për vendin ku kam lindur, të paktën për një ndeshje. Shpresoj që përballë Senegalit të bëjmë një paraqitje pozitive dhe të fitojmë. Kundërshtari është shumë i vështirë, por ne kemi besim se do të marrim fitoren e parë" deklaroi ai. Kosova në miqësoren kundër Senegalit do të jetë pa pesë lojtarë që u paraqiten kundër Turqisë. Kjo bëri që trajneri Bunjaku të fitonte përpos Mavrajt edhe Armir Rrahmanin, i

**Deklaratat**



**Bunjaku**

"Kemi 5 mungesa për ndeshjen me Senegalin, kam ftuar në Mërgim Mavrajn dhe Amir Rrahmanin. Do të mendohej të gjej edhe dy lojtarë të tjerë, për t'i zëvendësuar ata që mungojnë", tha Bunjaku.



**Vokri**

"Në muajin tetor, Kosova do të zhvillojë dy ndeshje miqësore më 9 tetor kundër Panamasë, në Nju Jork, në Red Bull Sarena Stadium, dhe më 12 tetor në Çikago kundër Kanadasë" shprehet Vokri.

cili luan me Partizanin dhe ka marrë pasaportën shqiptare. Rrahmani është një nga mbrojtësit më të mirë të kampionatit shqiptar të futbollit dhe shumë shpejt mund të zërë edhe një vend të padiskutuueshëm në kombëtare për krahas Canës dhe Mavrajt. "Meqenëse kishim 5 mungesa për ndeshjen me Senegalin, kam ftuar në Mërgim Ma-



Mërgim Mavraj, mbrojtës i kombëtares

# Kosova 'rrëmben' Mavrajn, siguron 2 miqësore luksi

Dy mbrojtësit do të veshin fanellën e Kosovës për një ndeshje miqësore

**Mavraj**

"Jam i lumtur që do të luaj për vendin ku kam lindur, të paktën për një ndeshje. Shpresoj që përballë Senegalit të bëjmë një paraqitje pozitive dhe të fitojmë" deklaroi Mavraj.

varaj dhe Amir Rrahmanin. Gjatë këtyre dy ditëve do të mendohej të gjej edhe dy lojtarë të tjerë, për t'i zëvendësuar ata që mungojnë", tha Bunjaku. Kreu i Federatës së Futbollit të Kosovës, Vokri ka deklaruar se në muajin tetor më datën 9 përfaqësuesja do të luajë në Nju Jork kundër Panamasë dhe më 12 tetor në Çikago

me Kanadanë. Nga këto dy ndeshje do të përfitojë 100 mijë euro. "Në muajin tetor, Kosova do të zhvillojë dy ndeshje miqësore, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mirëpo jo kundër tyre, por do të zhvillojë më 9 tetor kundër Panamasë, në Nju Jork, në Red Bull Arena Stadium, dhe më 12 tetor në Çikago kundër Kanadasë" shprehet Vokri.

LAJME  
**shkurt**

**Suarez qetëson: Do të jem në botëror**

— Pak ditë përpara fillimit të kampionatit botëror të Brazilit, kombëtarja e Uruguait ka marrë një lajm të keq. Sulmuesi i talentuar Luis Suarez është dëmtuar në meniskun e gjurit. Por pas operacioni sulmuesi qetësoi tifozët. "Ju faleminderit të gjithëve për mbështetjen. Rrini të qetë se do të luaj, do të punoj shumë për të qenë në 100% dhe për të ndihmuar shokët".



**Dëmtohet Van Persi, në dyshim për botërorin**

— Robin Van Persien ka pësuar një lëndim në gu në stërvitjen e së enjtes me kombëtaren e Holandës. Sulmuesi i Manchester Unitedit ka lënduar gjurin e këmbës së djathtë dhe në orët në vijim duhet t'u nënshtrohet testeve të radhës. 30-vjeçari vuante nga lëndimi në gu dhe rikthimi do të rrezikonte seriozisht pjesëmarrjen në kampionatin botëror të Brazilit.

# Magani ultimatum: Pretendentë ose iki

"Kam oferta nga Arabia Saudite , por dua të qëndroj për titullin e 25"

**Trajneri**

TIRANE

Pas një super edicioni të zhvilluar me ekipin e Tiranës, ku arriti që ta shpëtonte nga rënia, madje ta ngrinte në mesin e renditjes në përfundim të kampionatit, trajneri Gugash Magani mund të mos drejtojë bardheblutë për edicionin tjetër nëse nuk do të ketë një plan konkret nga drejtuesit e klubit. Edhe pse dëshira e trajnerit është e madhe që

të vazhdojë projektin e nisur me Tiranën, një gjë e tillë është e pamundur nëse nuk do të ketë një plan të qartë. "Kontrata ime me ekipin e Tiranës mbaron më 31 Maj. Kam biseduar për kontratën e re me donatorë, por nëse nuk ka plan të qartë rrezikojmë shumë, unë rri tek Tirana për titull dhe jo për mbijetesë. Zhvilluam një super edicion, falë mbështetjes së tifozëve, por edhe të donatorëve duke shpëtuar ekipin nga rënia. Megjithatë për të ardhmen jam skeptik" deklaroi ai. Trajneri Gugash Magani pas paraqitjes mjaft të mirë me ekipin e Tiranës edicionin që sapo lamë pas ka marrë edhe një ofertë për të drejtuar një ekip në Arabinë Saudite. Një

**Magani**

"Kam biseduar për kontratën e re me donatorë, por nëse nuk ka plan të qartë rrezikojmë shumë, unë rri tek Tirana për titull dhe jo për mbijetesë"



Gugash Magani

gjë të tillë e konfirmon edhe vetë tekniku, por shprehet se qëllimi i tij është që të fitojë titullin e 25-të kampion me Tiranën. "Është e vërtetë për

ofertën. Është vlerësim dhe diçka e mirë. Në Shqipëri ka trajnerë të mirë që mund të drejtojnë fare mirë edhe jashtë vendit. Ofertën e dëg-

jova me kënaqësi por kemi një projekt ambicioz tek Tirana. Kam dëshirë që 24 trofetë e fituar t'i bëjmë 25 dhe të jem unë trajneri i këtij ekipi" përfundoi ai. Pas përfundimit të kampionatit futbollistët e Tiranës janë në udhëkryq përpara për të ardhmes, pasi kontrata iu ka përfunduar dhe akoma nuk ka asnjë reagim nga drejtuesit e klubit se çfarë do të bëhet. Tirana është në të njëjtën gjendje si një edicion më parë ku u ndërhy vetëm në ditën e fundit të merkatos duke afruar disa futbollistë të cilët rezultuan se nuk ishin në gjendje që të shpëtonin ekipin, nëse në dimër nuk do të ishin afruar lojtarë cilësorë duke nxjerrë 24-herë kampionët nga kriza dhe vendi i fundit.

**CHAMPIONS**

**Simeone: Reali i rrezikshëm me çdo skemë**

— Trajneri i Atletico Madridit Diego Simeone ka deklaruar se Real Madridi do të mbetet gjithmonë ekip i rrezikshëm. "Ata kanë luajtur me tre mesfushorë dhe tre sulmues. Tani së fundmi ata kanë luajtur me rezultat 4-4-2 dhe u ka dhënë rezultate shumë të mira. Cilindo sistem që do të përdorin, me kalibrin e lojtarëve që ata kanë, ata do të jenë të rrezikshëm. Reali ka një ekip me lojtarë të mëdhenj. Ne do të tentojmë ta fitojmë finalen e madhe".



# PARADE FJALEKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

## HOROSKOPI

**Dashi**  
Do jeni me humor shume te mire gjate kesaj dite dhe te gatshem te shkonte deri ne fund te botes per ta bere partnerin te ndihet sa me mire. Çdo gjë do ece për mrekulli. Beqaret do ndjejnë shume për një mik te vjetër, por nuk do kenë kurajo t'ia thonë. Financat do jene delikate dhe shpesh do gjendeni ne situata goxha te vështira për t'u menaxhuar.

**Demi**  
Shfrytëzoheni sa te mundni këtë dite te bukur pranë atij qe dashuron dhe mos mendoni për asgjë tjetër. Do ndihen shume mire dhe zemra do gjejë qetësi. Beqaret do jene te vendosur për te përfutur nga çdo mundësi për aventura kalimtare dhe do ndihen me se miri. Ne planin financiar do jeni te qete duke qene se situata do jete e stabilizuar.

**Binjakët**  
Me ne fund do qeni paqen ne jetën tuaj ne çift dhe do ndihen te qete. Do e rivendosni komunikimin dhe bashkëpunimin. Beqaret do ëndërojnë shume për dashurinë ideale, por ajo ende nuk do vije. Do ju duhet te presin edhe disa dite, me shpenzimet duhet te bëni kujdes. Po nuk e shtrënguat pak rripin do keni vështirësi.

**Gaforja**  
Nëse qe ne mëngjes gjerat me partnerin nuk ecin mire, duhet te mendoni sa me pare te jeni një zgjidhje. Reflektoni me kujdes duke qëndruar vetëm dhe ne qetësi. Beqaret do kenë mbështetjen e Venusit dhe do gjenden pranë gjetjes se shpirtit binjak. Ne planin financiar fati do jete me ju. Mund te hiqni edhe disa para mënjane apo te bëni investime te rëndësishme.

**Luani**  
Do flisni gjere e gjate me partnerin tuaj sot dhe do i sqaroni edhe disa probleme qe keni pasur ju vetëm ne komunikim, por edhe ne jetën intime. Tregohuni sa me te hapur. Beqaret do kenë një dite te zakonshme, megjithatë te mbushur me emocione. Do ketë lakime me miq te vjetër. Financat do jene te mira kështu qe mund te planifikoni edhe ndonjë investim.

**Virgjëria**  
Tregohuni sa me diplomatë dhe te kujdesshëm gjate kesaj dite ne jetën tuaj ne çift. Vetëm ne këtë mënyrë marrëdhënia mes jush do jete e ngrohte dhe e kënaqshme. Beqareve do ju pelqejë pavarsësia qe kane dhe nuk do kërkohen te krijonë një lidhje shpesh e shpejt. Financat nuk do jene ne gjendje aq te mire sa për te kryer shpenzime kulturore. Kujdes!

**Peshorja**  
Fale mbështetjes qe do iu japë Merkurin, do luftoni fort sot me rutinën dhe problemet e vogla qe ju kishin dale ne çift. Marrëdhënia juaj do ketë goxha përmirësime. Beqaret do tërhiqen nga persona te se njëjtës shenje dhe qe vijnë nga jashtë. Beni kujdes sepse ju te gjithë mund t'u përshatën. Gjendja financiare do jete goxha e mire.

**Akrepi**  
Dile e vështirë kjo e solmja për ata qe janë ne një lidhje. Do e kritikoni shpesh një-tjetrin dhe marrëdhënia mes jush do lere për te dëshruar. Beqaret do mundohen shume te bëjnë për vete personin qe pelqejnë, por serish nuk do ja dalin dot mbanë. Financat do jene te mira nëse mateni mire para se te shpenzoni. Me pak kujdes mund te keni edhe përmirësime.

**Shigjetari**  
Do jeni shume melankolike gjate gjithë kesaj dite dhe shpeshherë do merrziteni. Ne fakt partneri nuk ehte ne humorin e duhur për t'ua shprehur te gjitha ato qe ndjeni. Beqaret nuk duhet te nxitohen dhe te marrin vendime te nxituare sepse ato do ndikojnë ne te ardhmen e tyre. Financat do jene goxha delikate kështu qe bëni kujdes me çdo shpenzim.

**Bircjapi**  
Do ju duhet te jeni me te kuptueshëm sot me partnerin dhe here pas here te bëni disa tolerime. Kompromisi duhet te jete një rregull i arte. Beqaret do kenë si synim vetëm gjetjen e një personi përshatshëm, nuk është shume e rëndësishme te dihet sa do zgjasë lidhja. Emocionet momentale janë ato qe ata preferojnë. Financat nuk do kenë probleme.

**Ujori**  
Klima ne jetën tuaj ne çift nuk do jete aspak e mire. Qe ne mëngjes do ketë debate te zjarrta me partnerin te cilat do duan koha te përmirësohen. Beqaret nga ana tjetër do kenë plot mundësi për takime emocionuese, vetëm se duhet te dine te bëjnë përzgjedhjet e duhura. Për financat do përkujdeseni tej mase. Gjendja sa vijen e do përmirësohet.

**Peshqit**  
Neptuni se bashku me disa planetë te tjere do e mbroje fort jetën tuaj ne çift gjate kesaj dite. Do e unani gjate gjithë kohës klimën e ngrohte dhe do ndihnen te gëzuar. Beqaret ka shume gjasë te takojnë një person interesant ne sallën e kinemasë apo te teatrit. Financat duhen riorganizuar sa me shpejt. Vetëm ne këtë mënyrë gjendja nuk do behet problematike.

## FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

**HORIZONTAL**  
1-Një është edhe i zërit.  
-Është muzull i tokës.  
2-Masat pa kufij.  
-Bëhet duke pranuar.  
-Gjysmë kuadri.  
3-Koloni për shkurt.  
-Emri i Zëzëq.  
-Është nivel edhe shoqëror  
4-Me One në një kërcim te dikurshëm.  
-Mirazhi karakteristik i ngushticës së Messinës.  
-Lumë në Gjermani.  
5-Janë ata që nuk hanë mish.  
6-Qendër ditore.  
-Janë kryetarët.  
-Një pjesë e madhësisë.  
7-Është një... specialist.  
-Ishte gjiganti me tre trupa.  
8-Njëloj si moral.  
-Kufizojnë ritmet.  
-Janë edhe ato dhjamore.  
9-Janë streha barinjsh.  
-Do plumb.  
-Agjencia Ajrore Spanjolle  
-Arti i romakëve.  
10-Në hyrje te tokës.  
-Këndon Together.  
-Një metër... për sipërfaqe.  
11-Një pjesë e ngushticës.  
-Shteti i francezëve.  
-Mund te jetë emëror.  
-Ndërmarrje Rajonale Tiranë  
12-Mund te jenë okulare.

**VERTIKAL**  
1-Janë makina që thirren.  
-Një gjë.  
2-Mbahren në polifoni.  
-Ishin për të peshuar dikur.  
-Gabime në ekstreme.  
3-Bën të fluturojnë shume hungarezë.  
-Me Quo në një grup rock.  
4-Di Capri i këngës italiane.  
5-Ente Proudhuse Sarandë.  
-Ishin kalendat që nuk vinin kurrë.  
-Iniciale te Morricone-s.  
6-Rrotë pa ekstreme.  
-Gjysmë e jermi.  
-Lindi Akilim.  
7-Farkëtoi armët e Akilit.  
-Pak latinisht.  
8-Është si zakan.

-Ngryt në mbremje.  
9-Si toreros.  
10-Një kullë në xhami.  
-Janë binarët.  
11-Një dinasti kineze.  
-Në krye të atletëve.  
12-Janë gratë e Zagrebit.  
-Fikse pa fe.  
13-Ajo del Gesu ishte violina e Paganini-t.  
-Agjenci Ajrore Kineze.  
14-Jessica aktore.  
-Kushi ka ka zë.  
15-Në krye te garës.  
-Janë Kohë... të Charlie Chaplin.  
16-Është zeshkani.  
-Janë elektret e padëshnuara të llageve  
17-Në fund të vitit.  
-Emër djali.  
-Kufizojnë rajonet

E	P	I	L	O	G	U	D	Y	S	H	I	M	P	I
M	I	S	T	E	R	I	O	Z	A	S	A	G	A	N
E	C	T	K	A	G	N	T	A	R	A	R			
R	A	D	N	S	P	E	R	I	T	E	R	T	A	
I	D	O	L	D	H	J	E	T	E	G	A	R	E	S
T	O	R	E	A	U	T	O	M	O	B	I	L	U	
U	R	I	T	E	R	I	T	O	R	I	A	L	E	
A	E	D	E	R	R	A	I	O	I	R	D			
R	S	A	R	R	A	S	M	I	O	K	O	I		
S	J	O	T	S	I	N	T	E	R	E	S	A		
I	R	T	O	L	I	N	D	I	A	N	E	T		
A	L	T	I	N	E	C	J	A	R	O	M	A	K	E

Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë

## Sudoku

			4	6		1	3				
			6	4	8	7	5				
7	9	8					6	4	1		
1	5				2				6	9	
	3			7		5			1		
8	4			6					3	5	
2	7	3						9	5	6	
			1	5	3	2	8				
			5	9		6	1				

**Përgjigje**  
9 1 8 7 2 3 6 5 4  
2 3 4 6 8 5 9 1 7  
6 5 7 9 4 1 3 8 2  
4 6 3 2 5 9 8 7 1  
5 2 9 1 7 8 4 3 6  
7 8 1 4 3 6 2 9 5  
1 4 2 3 9 7 5 6 8  
8 9 6 5 1 4 7 2 3  
3 7 5 8 6 2 1 4 9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

## FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

**Përgjigje**

B	I	Z	A	P	E	R	H	E	N	D
A	Z	I	N	A	H	E	N	I	N	A
Z	A	H	E	N	I	N	A	H	E	N
H	E	N	I	N	A	H	E	N	I	N
I	N	A	H	E	N	I	N	A	H	E
H	E	N	I	N	A	H	E	N	I	N
N	I	N	A	H	E	N	I	N	A	H
H	E	N	I	N	A	H	E	N	I	N
I	N	A	H	E	N	I	N	A	H	E
N	I	N	A	H	E	N	I	N	A	H

10	7	9					5	8		6	10	15	5	6
2	4	7	11	5	14	7	4	5						1
3	5	9	5	10	2	16	12	3	5	14				
7		4	12	10	7	14	5	14	7			3	12	
11	2		3	12	8			5	9			12	15	
2	9	14	5	3	7	15		9	17	5	16	2		
3	2		14	7	12		8	7	2	11	5			
			13		11		16	7	14			13	16	
10	2	3	4	12		8	8	5	3	5			12	
2	16	2				10	2	8	5	14	6			6
3	2		13	11	7	4	5		11	5	14	12		
9	14	2	16	5	14	2		6	12	3	7	9		

**Përgjigje e fjalëkryqit sportiv**

H	A	S	T	G	O	L	B	O	K	S				
A	T	A	S	G	I	O	R	G	I	O				
A	L	I	B	E	P	E	N	D	A	L	K			
N	E	R	F	R	E	N	D	A	L	K				
A	K	R	W	A	Y	N	E	R	O	N	E	Y	L	
L	R	O	B	I	N	V	A	N	P	E	R	S	I	E
B	S	B	S	A	T	A	A	E	E					
A	T	L	E	T	S	I	R							
N	E	S	T	S	H	A	A	R	A	U	A	N	T	

48. Kështu thirret Agjorio.  
**VERTIKAL**  
1. Dy herë... në skenë.  
2. Kufijet e lëvizjes.  
3. Dy asa.  
4. Fillojnë masat.  
6. ...Antonio Spurs në NBA.  
7. Eshtë për medaljen e parë.  
8. ... King ish-legjendë e tenisit.  
9. Një... dollar.  
10. Qendër kurimi.  
11. Vidal te Juventus.  
13. Ka shume një ndeshje derby.  
14. Giuseppe ndër drejtuesit e Juventus.  
15. Janë edhe ato antidoping.  
17. Strakosha që qe portier.  
18. Nigel te Milan.  
19. Skuadër greke.  
21. Hamilton pilot.  
22. Lendi, ish-tenist.  
23. Një pjesë e incidenteve.  
26. Tim aktor.  
27. Monica ish-teniste.  
28. Kufizojnë vendet.  
30. New York... me editoriale.  
31. Një pjesë e hamendjes.  
35. Garcia trener te Roma.  
38. Spitz i famshëm i notit.  
41. Italia në tabelë.  
42. Ndalet pa det.  
46. Fillojnë turnin.

## FJALËKRYQI SPORTIV

			2	3		4		5	6		7	8	9		10
			11		12			13			14				
			16					17							18
			19	20	21	22					23			24	
25															28
			29	30										32	
			33	34				35						37	
								39	40					41	
			42					43						45	
46													48		

**HORIZONTAL**  
1. Bekim futbollist i yni.  
4. Çota te bardheblutë (inic).  
5. Sapo fillojnë.  
7. Valëro te Fiorentina.  
11. Errani teniste.  
13. Edi, trainer.  
15. Fillojnë sfiden.  
17. De Rossi te Roma.  
18. Mbyllin fushatat.  
19. Giroud te Arsenal.  
23. Të parat në slalom.  
24. Uruguaji në tabelë.  
25. Raslisiin në krye.  
26. Personazhi në foto.  
28. Mirë në qendër.  
29. Personazhi në foto.  
31. Kufizojnë elemente.  
32. Beson pa kufij.  
33. Një garë e vështirë me motoçikleta.  
35. Pak iniciative.  
36. Te fundit në koment.  
37. Matje pa zanore.  
38. Mats te Borussia Dortmund.  
39. Jean, ish-mestfushor francez.  
42. Gianni... Biasi në stolin tonë.  
43. Një mund të fitohen me tie break.  
44. Dobroski aktore.  
46. Hidhej një nga Ai Oerter.  
47. Ka vijën fatale.

**LAJME nga botë**

**Shkup, qetësohen gjakrat, mbetet frika**

Pas protestave të dhunshme, situata në lagjen Gjorçe Petrov të Shkupit ditën e enjte paraqitet e qetë, por edhe më tej e tensionuar. Nëpër rrugët e kësaj lagjeje vërehet prezencë e shtuar e policisë, ndërsa tek banorët shqiptarë ekziston ndjenja e pasigurisë. Vetëm ndaj 5 protestuesve është shqiptuar masa e paraburgimit prej 7 ditësh. Ndaj grupit tjetër janë ngritur padi për kundërvajtje dhe janë vendosur gjoha për pjesëmarrje në turma dhe dhunë. Organizata joqeveritare "Zgjate dorën" nga Tetova ka paralajmëruar se do të kërkojë nga qeveria zhvendimin e pronarëve shqiptarë, që u dëmtuan për rreth 3 milionë euro.

**Incident me armë në kufirin mes dy Koreve**

Korea e Veriut ka lëshuar disa raketa në ujërat territoriale të diskutuara, pranë një anijeje të Korës së Jugut, ka njoftuar ushtria koreano-jugore. Ngjarja ka ndodhur pranë një ishulli, në kufirin e diskutueshëm perëndimor, raporton agjencia e lajmeve "Yonhap". Të martën ishte Jugu që qëlloi disa herë si paralajmërim ndaj tri anijeve të Veriut, të cilat kishin kaluar kufirin detar. Nga ana e tij Pheniani deklaroi se do të hakmerrej. Banorët e ishullit ku ndodhi ngjarja u evakuuan nga frika. Tensionet mes dy vendeve fqinje janë rritur shumë së fundmi, me Phenianin që përdor terma ofenduese ndaj liderëve në Seul dhe Washington.

**Tajlandë, ushtria kryen grusht shteti**

Ushtria tajlandeze shpalli dje një grusht shteti, duke pezulluar Kushtetutën dhe shkarkuar qeverinë, por vendosi që të mbajë në fuqi Senatin. "Kushtetuta e vitit 2007 u pezullua, me përjashtim të kapitullit mbi monarkinë", deklaroi zëdhënësi i ushtrisë në television, duke theksuar se "kjo do t'i mundësojë ushtrisë drejtimin e vendit me normal". "Senati vazhdon të punojë si gjithnjë, ndërkohë që qeveria është shkarkuar", theksoi ai. Ushtria urdhëroi kryeministrin e rrëzuar dhe ministrat e tij që të paraqiten në zyrat e ushtrisë deri në fund të ditës së djeshme.

**Emisioni drejtohet nga gazetarja Mirjeta NGJELA**

**Aktualiteti, tema e ditës, ngjarjet më të bujshme, tematikat sociale etj... trajtohen nga e marta në të premte në studion e URBANIKA**

**nga e marta në të premte ORA 20:30**

na ndiqni *live* në tv **A1 REPORT!**

**FTESË PËR BASHKËPUNIM**

Kompania Elkos shpk, distributor ekskluziv i kondicionerëve AUX në Shqipëri dhe Kosovë, është e interesuar për të bashkëpunuar me kompani distributore dhe instaluese.

Ofrimë llojshmëri të gjerë të kondicionerëve duke filluar nga 9 000 BTU deri në 60 000 BTU, me të cilët plotësojmë nevojat për vendbanime dhe biznese si restorante, hotele dhe lokale me hapësira të ndryshme për ftohje dhe ngrohje duke ofruar edhe kondicioner inverter. Ftohen të gjitha kompanitë e interesuara për marrëveshje ofatgjata bashkëpunimi për tregëtimin dhe instalimin e kondicionerëve AUX, kondicionerë cilësorë sipas standardeve Evropiane dhe me çmime të lira.

**Jeta është e mrekullueshme!**

Të interesuarit të kontaktojnë në e-mail: elkoseast@elkosgroup.com; ardian.aliu@etc-ks.com; ardian.aliu@gmail.com; Tel: +355 69 74 26 77 1, Kosovë Cel: +386 49 772 162

**SHTYPI DHE JU**

Çdo ditë 07:00 nga Artur Nura

**ME MODERATOR GAZETARIN E MIRËNJOHUR ARTUR NURA**

**EMISIONI TELEVIZIV "SHTYPI DHE JU" ËSHTË EMISION I PËRDITSHËM QË TRANSMETOHET DIREKT NGA ORA 07:00 - 07:55 NË TV:**

**A1 REPORT!**

Struktura e emisionit konsiston në leximin telegrafik të titujve kryesorë të gazetave të përditshme dhe një sondazh direkt me telefonata nga qytetarët

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor  
 Genc Kondi- Administrator i Përgjithshëm & Ekonom; Admirina Peçi- Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Brahim Shima ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ; Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sport: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Genti Manelli ; Website: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696088847  
 Departamenti i Marketingut: Vera Përleka  
 Cel: +355696060419  
 marketing@shqiptarja.com  
 Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail:redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë